




Republika e Kosovës
Republika Kosovo/Republic of Kosovo
Komuna Dragash/ Opština Dragaš/ Dragas Municipality



RAPORTI I PUNES I KRYETARIT DHE ORGANEVE EKZEKUTIVE TE
KOMUNES SE DRAGASHIT PER VITIN 2022



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
Komuna e Dragashit
Opština Dragaš

Nr. Br. 020/01-3698/23
16-02-2023
Dragash - Dragaš



Kryetari i Komunës
Bexhet Xheladini

Janar 2023

Qytetarë të Komunës së Dragashit,

Të nderuar asambleistë,

Bazuar në Ligjin mbi vetëqeverisjen lokale Nr. 03/L-040 dhe statutin e Komunës së Dragashit 01 Nr.06-103/1, të datës 11.09.2008, kam nderin dhe kënaqësinë që para jush të paraqes Raportin Vjetor Janar-Dhjetor 2022, për të arriturat, sukseset, angazhimet, por edhe sfidat dhe vështirësitë me të cilat është përballur Komuna e Dragashit gjatë vitit 2022.

Pas certifikimit të rezultateve nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për raundin e tretë – përsëritja e votimit nga diaspora – filluam procedurat e konstituimit të Asamblesë Komunale. Me datën 28.12.2021 zhvilluam seancën e betimit të Kryetarit të Komunës, me ç’rast iu hap rrugë konstituimit të organeve tjera përcjellëse, siç janë zgjedhja e Nënkryetarit, zgjedhja e Nënkryetarit për Komunitete, si dhe Drejtorët e Drejtorive Komunale.

Meqenëse Komuna e Dragashit në përbërjen e saj ka pjesëtarë të komuniteteve shqiptar, goran dhe boshnjak, me qëllim të përfaqësimit sa më korrekt dhe të drejtë të qytetarëve në institucionet komunale, edhe përbërja e Drejtorëve të Drejtorive Komunale reflekton përfaqësimin e të gjitha komuniteteve. Nga tetë drejtori komunale, katër prej tyre drejtohen nga komuniteti shumicë (Drejtoria e Administratës, Drejtoria e Arsimit, Drejtoria për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim, dhe Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport) dhe katër të tjera nga komunitetet joshumicë (Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Ambientit, Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Drejtoria për Mbrojtje, Shpëtim dhe Shërbime Publike dhe Drejtoria për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Inspekcione).

Si rezultat i punës së përbashkët dhe bashkëpunimit të mirë brenda dhe jashtë institucionit, kemi arritur që të kryejmë pjesën më të madhe të objektivave programore. Që të jetë sa më transparente për publikun, Komuna e Dragashit përmes këtij dokumenti ka ofruar një pasqyrë të përgjithshme të aktiviteteve të saj, për t’u dhënë mundësi qytetarëve që të njohin dhe vlerësojnë punën e institucioneve komunale.

Gjatë këtij viti kalendarik, organet ekzekutive të komunës janë angazhuar për një qeverisje komunale transparente, efikase, llogaridhënëse, gjithëpërfshirëse, me shërbime të shpejta për të gjithë qytetarët e komunës sonë, pa dallim.

Puna e Kryetarit të komunës është zhvilluar përmes tetë drejtorive dhe shërbimeve përcjellëse të komunës, si Zyra Lokale për Komunitete dhe Kthim, shërbimi i Kuvendit, Zyra e Prokurimit, Zyra për Barazi Gjinore, Auditori i Brendshëm etj. Në harmoni me legjislacionin në fuqi, udhëzimeve administrative dhe statutit të komunës, Kryetari i Komunës ka mbajtur 11 takime të bordit të drejtorëve dhe vazhdimisht ka përcjellur punën e drejtorëve, duke vlerësuar performancën e tyre dhe, përmes tyre, edhe të shërbyesve civilë në të gjitha nivelet në komunë.

Është siguruar nja ambient i qetë, tolerant, demokratik dhe bashkëpunues në mes të drejtorive dhe stafit, duke eliminuar çdo pakënaqësi apo pabarazi individuale dhe kolektive. Dialogu me palët dhe qytetarët ka qenë prioritet i imi. Përveç që janë pritur me qindra palë në zyrë të Kryetarit, gjithashtu janë mbajtur edhe takime me qytetarë në të gjitha lokalitetet, ku jemi njoftuar për së afërmi me kërkesat dhe prioritetet e tyre.

Planifikimi i buxhetit për vitin 2023 është bërë pas debateve që kemi pasur me qytetarë dhe, si rezultat i kësaj, buxheti është miratuar në mënyrë unanime, me votat e asambleistëve të të gjitha partive politike në Kuvend.

Një kujdes i veçantë i është kushtuar transparencës së punës së organeve të komunës, ku të gjitha vendimet kërkesat, shpalljet, thirrjet, raportet periodike të realizimit të buxhetit, janë publikuar në uebfaqen e komunës në të dy gjuhët.

Organet komunale janë angazhuar fuqishëm në rritjen e efikasitetit të shërbimeve komunale, si ato administrative, po ashtu edhe shërbimet e furnizimit, siç është uji i pijshëm. Pastaj investimet e ndryshme kapitale, ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e rrjetit të kanalizimit, rrugëve, transporti, menaxhimi i mbeturinave, ndriçimi publik, mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugëve etj. Sa i përket mirëmbajtjes së rrugëve gjatë sezonit të dimrit, mbrojtjes së natyrës dhe ofrimit të shërbimeve sa më efikase shëndetësore, komuna ka shpallur thirrje publike për realizimin e këtyre shërbimeve.

Buxheti i aprovuar për vitin 2022 është realizuar në masën 95%. Sfidë ka qenë realizimi i buxhetit për investime kapitale, për shkak të problemeve të trashëguara nga qeveria e kaluar, siç janë projektet 2-3 vjeçare dhe mungesa e kompanisë për hartimin e projekteve.

Komuna, përmes Zyrës së Prokurimit, ka realizuar me sukses 168 projekte kapitale dhe furnizime. Si rrjedhojë e punës efikase të Drejtorisë së Urbanizmit, procedurave ligjore të

tenderimit nga ana e Zyrës së Prokurimit, mbikëqyrjes profesionale të punimeve, vizitave të shpeshta të Kryetarit të Komunës nëpër vendpunishte, komisioneve profesionale për pranimin teknik të punimeve etj., është bërë një punë kualitative dhe e qëndrueshme.

Kryetari i Komunës ka vazhduar praktikat e takimeve, vizitave dhe bashkëpunimit me të gjithë, me qëllimin e vetëm që të bëjë diçka të mirë për komunën tonë. Së bashku me kryetarët e komunave të Kosovës kanë qenë në Turqi për të parë praktikat e avancuara të menaxhimit të mbeturinave. Në kuadër të programit për bashkëpunim ndërkuftar IPA, kemi vizituar Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe kemi nënshkruar memorandumin e bashkëpunimit, ku ne si komunë lidere kemi konkuruar për projektin në programin IPA.

Kryetari i Komunës ka marrë pjesë në të gjitha takimet që i kanë organizuar organet qendrore, ministritë, institucionet ndërkombëtare, Asociacioni i Komunave etj. Zyrën e Kryetarit e kanë vizituar shumë investitorë të huaj, të cilët janë të interesuar që të investojnë në energji të ripërtëritshme, në blegtori dhe turizëm, por sfidë ka qenë mungesa e tokës. Siç jeni në dijeni, 57% e territorit tonë është park nacional, pjesën më të mirë të tokës e menaxhon AKP-ja, ku lënda është në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme. Po ashtu, pjesën tjetër të tokës e menaxhon Agjencioni Pyjor i Kosovës.

Sfida më e madhe për ne është papunësia dhe rritja e kërkesave për ndihma sociale, ndihma për mjekim, barëra etj. Zyra e Kryetarit ka pasur të planifikuara 100 mijë euro për raste të tilla, të cilat kanë qenë të pamjaftueshme. Për bujqit dhe blegtorët viti që po e lëmë pas ka qenë sfidues, për shkak të dimrit të gjatë, krizës ekonomike, ngritjes së çmimeve të ushqimit për kafshët etj. Nga kategoria buxhetore e subvencioneve dhe transfereve, kemi ndarë mjete financiare në vlerë prej 90 mijë euro për të gjithë blegtorët e regjistruar, bletarët dhe kultivuesit e shpezëve. Gjithashtu, nga kjo kategori buxhetore kemi ndarë 10 mijë euro për organizimin e panairit të prodhimeve vendore – lokale.

Gjatë vitit të parë kalendarik në fokus ka qenë realizimi i programit qeverisës dhe në këtë drejtim janë bërë shumë investime në arsim, kulturë, rini dhe sport, në shëndetësi, infrastrukturë etj. Janë organizuar shumë manifestime kulturore, ngjarje sportive, janë bërë shumë shpallje publike, nga të cilat kanë përfituar shoqatat, klubet, organizatat joqeveritare, shoqëritë kulturore-artistike, shoqatat e veteranëve, pensionistëve, të gjitha lokale. Është mbajtur Festivali Folklorik-Burimor “Opoja Vallëzon” dhe për herë të parë në historikun e komunës janë mbajtur dy

manifestime ‘‘Ditët e Diasporës’’, njëri në Brod dhe njëri te Liqeni i Breznes. Kemi ndarë 114 bursa për studentët e komunës sonë. Për Shoqatën ‘‘Jetimat e Ballkanit’’ kemi ndarë 40 mijë euro për ndërtimin e shtëpive të banimit për skamnorët.

Nën patronatin e Kryetarit të Komunës është bërë shënimi i të gjitha datave të rëndësishme: dita e shpalljes së Pavarësisë, Epopeja e UÇK-së, Dita e Dëshmorëve, Dita e Çlirimit dhe Dita e Flamurit. Kryetari i Komunës ka marrë pjesë në të gjitha manifestimet e organizuara me rastin e shënimit të ditës së shkollave. Gjithashtu janë vizituar në vazhdimësi të gjitha institucionet komunale, si qendrat mjekësore, shkollat, QPS, kompanitë regjionale, Policia e Kosovës etj. Me propozimin e kryetarit të Komunës, Asambleja Komunale me vota unanime ka shpallur qytetare nderi të Komunës së Dragashit zonjën Janet Reineck.

Sa i përket çështjes së sigurisë, komuna jonë ka qenë komunë e qetë dhe stabile, pa probleme të theksuara në aspektin e sigurisë së përgjithshme. Bashkëpunimi me Policinë e Kosovës ka qenë në nivel, në kuadër të kompetencave dhe ligjeve në fuqi. Gjatë këtij viti kalendarik janë mbajtur 6 takime të KKSBS-së, ku të gjithë akterët relevantë për çështje të sigurisë në komunën tonë kanë raportuar me shkrim.

Të gjitha aktivitetet dhe e gjithë puna e organeve komunale është përfshirë në raportin e tetë drejtorive, Zyrës për Komunitete dhe Kthim, Zyrës së Prokurimit, Zyrës për Barazi Gjinore, dhe janë pjesë përbërëse e punës së Kryetarit të Komunës.

Prioritetet tona kryesore në vitin e dytë qeverisës do të jenë:

- Administratatë efikase dhe me shërbime të shpejta
- Qeverisje transparente, githëpërfshirëse dhe llogaridhënëse për të gjithë qytetarët e Komunës së Dragashit
- Realizimi me sukses i projekteve kapitale
- Furnizimi efikas me material hargjues
- Realizimi efikas i buxhetit komunal
- Realizimi i planit për të hyrat vetanake
- Furnizimi me ujë të pijshëm
- Investime në infrastrukturë
- Ndriçimi publik

- Ndërtimi i trotuareve dhe shtigjeve të ecjes për këmbësorë dhe biçiklistë
- Zhvillimi i turizmit dhe infrastrukturës përcjellëse
- Rritja e përkrahjes për fermerët dhe bujqit
- Rritja e cilësisë në arsim dhe investime në infrastrukturë
- Transporti nxënësve dhe bursa për studentë
- Shërbime efikase shëndetësore dhe investime në infrastrukturë shëndetësore
- Hartimi i Planit Zhvillimor Komunal dhe hartave zonale
- Krijimi i kushteve për investime në energji të ripërtëritshme, në bujqësi, blegtori dhe turizëm, si mundësi për hapjen e vendeve të reja të punës dhe zhvillim ekonomik
- Investime në kulturë, rini dhe sport
- Bashkëpunimi me kompani publike për shtimin e kapaciteteve dhe kualitetit të ujit të pijshëm, shërbime më efikase në grumbullimin e mbeturinave, futjen në sistemin e menaxhimit të mbeturinave për fshatrat të cilat nuk janë në sistem, me qëllim të krijimit të nja ambienti sa më të pastër
- Vizita në të gjitha lokalitetet e komunës dhe debat me qytetarët për t'u njoftuar për së afërmi me kërkesat e tyre
- Bashkëpunimi i ngushtë me organet qendrore dhe ato lokale, me ambasadat, KFOR-in, ojq-të vendore dhe ndërkombëtare, klubet, asociacionet, shoqatat, shoqëritë etj.

Nr.		
	Përshkrimi i lëndëve	
	Lëndët e miratuara nga kryetari i komunës së Dragashit për vitin 2022	
	I	
1	Vendime për mjete për shërim	212
2	Vendime për mjete për shkollim	15
3	Vendime për mjete për momentale	7
4	Vendime për mjete për kompensim dëmi	5
5	Vendime për mjete për botim libri	4
6	Vendime për mjete për OJQ	3
7	Vendime për mjete për familjen strehuese	1
8	Vendime për mjete për U. Ukshin Hoti	1
9	Vendime për mjete për pjesëmarrje në olimpiadë	1
10	Vendime për mjete për org. e pensionistëve	1
11	Vendime për mjete për person. me nevoja të Veçanta	1
12	Vendime për mjete për video klip	1
	Gjithsejtë	252 Vendime
1	<u>Refuzime të kërkesave</u>	57
	<u>Mjetet e lejuara nga pozicionet tjera</u>	
	II	
1	Vendime për mjete për ekspozitë	1
2	Vendime për mjete për maturantët	1
3	Vendime për mjete për punë jashtë orarit	18
4	Vendime për udhëtime zyrtare	11
5	Vendime për mjete për paga përcjellëse	7
6	Vendime për mjete për dreka zyrtare	3
7	Vendime për mjete për Asociacionin e komunave	1
8	Vendime për mjete për komisionin për grumb. e dëshmime (8 anëtar)	1
9	Vendime për mjete për AZHR-së	1
10	Vendime për mjete për ekzekutimin e kontratave	13
11	Vendime për mjete për ekzekutimin e marrëveshjeve	7
12	Vendime për mjete për kartela telefonike	32
13	Vendim për lejimin e mjeteve vizitë studimore	1
14	Vendim për ndarjen e bursave (114 përfitues)	1
15	Vendime të tjera	13
	Gjithsejtë	111 Vendime

	III Marrëveshje, Memorandume , Kontrata	
1	Marrëveshje – Komuna Dragashit me K.R.M. Ekoregjioni Sh.A. – për mirëmbajtjen e Deponisë	1
2	Marrëveshje Mirëkuptimi – Komuna Dragash – Hidroregjioni Jugor Sh.A Prizren për dhurimin e pajisjes “Makinë për prerjen e Asfaltit”, dhe dhurimin e paisjes “Pajisje detektuese për rritjen nëntokësore të ujësjellësit” (2marrëveshje),	1
3	Marrëveshje Bashkëpunimi dhe Bashkëfinancimi Komuna Dragashit – dhe Human Care	1
4	Marrëveshje për Bashkëfinancim të Projektit Komuna e Dragashit – K.R.U. Hidroregjioni Jugor Sh.A. Prizren – Furnizimi me pajisje detektuese për rrjetat nëntokësore të ujësjellësit dhe makinë sharrë për prerjen e asfaltit	1
5	Marrëveshje Bashkëfinancimi mes Komunës së Dragashit dhe Policisë së Kosovës – Ngritja e Sigurisë Publike dhe Bashkëpunimit	1
6	Marrëveshje Bashkëpunimi ndërmjet Komunës së Dragashit dhe Universitetit të Prizrenit “Ukshin Hoti” – Shkolla Verore ndërkombëtare 2022	1
7	Marrëveshje Bashkëpunimi – Komuna e Dragashit – Përfaqësuesit e f.sh. Restelicë – Projekti lidhur me bazenin (rezervuarin) e ujit	1
8	Marrëveshje Bashkëpunimi dhe Bashkëfinancimi Komuna e Dragashit – Shoqata Bamirëse “Jetimat e Ballkanit” – ndertimi I 5 shtëpive	1
9	Marrëveshje Mirëkuptimi – Komuna e Dragashit – Ministria e Zhvillimit Rajonal – “Renovimi I shkollave në f.sh. Pllajnik dhe Zym”	1
10	Marrëveshje për shërbime të Ujësjellësit dhe Ujërave të ndotura – Komuna Dragashit dhe KRU “Hidroregjioni Jugor” Sh.A. Prizren	1
11	Marrëveshje Bashkëpunime Komuna e Dragashit – OJQ “PARTNERSKOSOVA” - Fuqizimi dhe rritja e ndërgjegjësimit Grupi I Grave Avokuese për Barazi Gjinore”	1
12	Marrëveshje Bashkëfinancimi Komuna e Dragashit – “IOM”, Përmirësimi i jetesës dhe rritja e mundësive për punësim	1
13	Marrëveshje Bashkëfinancimi Komuna e Dragashit – Ekoregjioni “Furnizimi me kontinierë për hedhjen e mbeturinave	1
14	Marrëveshje Komuna e Dragashit – Eko-regjioni “Largimi i mbeturinave”	1
15	Memorandum Bashkëpunimi Komuna e Dragashit dhe KEDS - Furnizimi me Energji Elektrike Sh,	1
16	Memorandum mirëkuptimi – për Qendrën për Strehimin e Grave dhe Fëmijëve”	1
17	Memorandum i Bashkëpunimit Komuna Dragash dhe Agjencisë Kadastrale të Kosovës – Kompletimi i Sistemit të Adresave në Territorin e Komunës	1

18	Memorandum Mirëkuptimi – Komuna e Dragashit me Komunën e Zhelinës në Republikën e Maqedonisë së Veriut “Promovimi i potencialeve turistike malore të Rajonit të Sharrit”	1
19	Memorandum mirëkuptimi Komuna e Dragashit – Shoqata Humanitare Bamirëse të Kosovës “Nënë Terezë” Prishtinë	1
20	Kontratë për dhënien në Menaxhim me qira të Vend gjuetisë së Përbashkët në Komunën e Dragashit, Kontratë për Ndarjen e Mjeteve Financiare e Lidhur ndërmjet Komunës së Dragashit dhe OJQ “ZAENO BROD” 4.000,00Euro	1
21	Kontratë për Ndarjen e Mjeteve Financiare e Lidhur ndërmjet Komunës së Dragashit dhe OJQ “AVOKO” Ditët e diasporës 5300,00Euro,	1
22	Kontratë për Ndarjen e Mjeteve Financiare Komuna e Dragashit – Organizimi i Festivalit Folkloriko –Burimor “OPOJA VALLËZON”, 12,000,00Euro	1
23	Kontratë për Ndarjen e Mjeteve Financiare Komuna e Dragashit – SH.K.A. “FIDANI”, 3300,00 Euro	1
24	Kontratë për Ndarjen e Mjeteve Financiare Komuna e Dragashit – OJQ “AVOKO” 3000,00Euro	1
25	Kontratë për Ndarjen e Mjeteve Financiare Komuna e Dragashit – OJQ “QENDRA”	1
26	Kontratë për Ndarjen e Mjeteve Financiare Komuna e Dragashit – OJQ “DEMOKRATSKA OMLADINA GORE”	1
27	Kontratë për Ndarjen e Mjeteve Financiare Komuna e Dragashit – OJQ “SHOQËRIA KULTURORO-ARTISTIKE BRESANA” 8430,00 Euro	1
28	Aneks Kontratë – Për shërbime postare	1
29	Kontratë për Ndarjen e Mjeteve Financiare Komuna e Dragashit – “Klubi Futbollistik” OPOJA 35.000 Euro	1
30	Kontratë për Ndarjen e Mjeteve Financiare Komuna e Dragashit – “FC AROMA” 5000.00Euro	1
31	Kontratë për Ndarjen e Mjeteve Financiare Komuna e Dragashit – “FC Dragash Sport” 5000.00Euro	1
32	Kontratë për Ndarjen e Mjeteve Financiare Komuna e Dragashit – Klubi i Shahut 4000.00 Euro	1
33	Kontratë për Ndarjen e Mjeteve Financiare Komuna e Dragashit – Klubi i Kuajve 10.000 Euro	1
34	Kontrata Pune	9
	Gjithsejtë	42

	III Kërkesa Ministrive dhe Org. tjera	
	Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	
1	Kërkesë për asfaltimin e rrugës Bresanë – Erza – Kroi i Zgatarit – Guri i vesës	1
2	Kërkesë për rehabilitimin e rrugës Xërrxe Pllajnik	1
3	Kërkesë për futjen e rrugëve nën menaxhimin e Drejtorisë Rajonale të mirëmbajtjes së Rrugëve	1
4	Kërkesë për lirim nga pagesa për kullosa për vitin 2022 në parkun nacional për blektorët e Komunës së Dragashit	1
5	Kërkesë për asfaltimin e Stacionit të Autobusëve – Dragash	1
6	Kërkesë për financimin e projektit të rrugës Kapre - Rrenc	1
7	Kërkesë për financimin e asfaltimit të rrugës Zlipotok, Globocic , Baçkë, dhe Brod	1
8	Kërkesë për Financimin e Ujësjellësit për 16 fshatra dhe qytezën e Dragashit – nga Fondet e IPA	1
9	Kërkesë për ndërtimin e rrugës përgjat lumit Pllavë- që lidh komunën e Dragashit me Kukësin	1
10	Kërkesë për Shpronësim të objektit në ngastrën Kadastrale në f.sh. Bresanë (Objekti i Sharrprodhimit)	1
11	Kërkesë për aprovimin e Planit të pastrimeve sanitare në Parkun Kombëtar "SHARRI"	1
12	Kërkesë për shpronësimin të ngastrës kadastrale në f.sh Bresanë – Pronë e Sharrprodhimit	1
13	Zyrës së Kryeministrit – Kërkesë për hapjen e rrugës së stadiumit të qytetit	1
14	Ministrisë së Bujqësisë – Kërkesë për dhënien e pëlqimit për themelimin e vendgjuetisë së përbashkët "SHARRI" Dragash	1
15	Ministrisë së Kulturës – Kërkesë për financimin e ndërtimit të sallës Sportive në f.sh. Bresanë	1
16	Ministrisë së Kulturës –Kërkesë për ndërtimin e Stadiumit të qytetit dhe infrastrukturës përcjellëse në Dragash	1
17	Bordit Drejtorave të AKP-së Prishtinë – Kërkesë për heqjen – pezullimin nga privatizimi i shitores së Sharrprodhimit Pronë e AKP-së në f.sh. Bresanë	1
18	Ministrisë së Bujqësisë – Kërkesë për shqyrtimin e vendimit të Inspektionit të pylltarisë	1
19	Ministrisë së Punëve të Brendshme – Kërkesë për harmonizimin e Koficienteve për zyrtarët administrativ të Komunës	1

20	Agjencia Kosovare e Privatizimit – Zyra Rajonale Prizren – Kërkesë për mos shitjen – privatizimin të pronës Z.K Bresanë	1
21	Agjencioni pyjor i Kosovës – Kërkesë për dhënien e pëlqimit për hapjen e rrugës në bashkëfinancim me KFOR-in Turk	1
	Gjithsejtë	21
	Komisionit për Buxhet dhe Financa të Kuvendit të Kosovës (Kërkesat për vendosjen në Projekte Qeveritare)	
1	Kërkesë për Vendosjen në projekt Qeveritar – Ndërtimi i rrugës përgjat lumit Pllava e cila lidh Komunen e Dragashit me Bashkinë e Kukësit në Republikën e Shqipërisë	1
2	Kërkesë për Vendosjen në projekt Qeveritar – për financimin e rrjetit të Ujësjellësit dhe Fabrikës së përpunimit të Ujit për K.Dragash dhe 15 Fshatrat	1
3	Kërkesë për Vendosjen në projekt Qeveritar – për financimin e ndërtimit të Stadiumit të Qytetit dhe Infrastrukturës Përcjellëse	1
4	Kërkesë për Vendosjen në projekt Qeveritar dhe Ministrisë së Financave– për renovimin e kulmit të 2 Banesave në Qytezën e Dragashit	1
5	Përfaqësuesja Speciale e Sekretariatit të përgjithshëm të OKB-së në Prishtinë znj. Caroline Ziadeh - Kërkesë për Autoambulancë	1
6	Përfaqësuesja Speciale e Sekretariatit të përgjithshëm të OKB-së në Prishtinë znj. Caroline Ziadeh - Kërkesë për blerjen e 2 traktorëve për pastrimin e Rrugëve nga Bora	1
7	Përfaqësuesja Speciale e Sekretariatit të përgjithshëm të OKB-së në Prishtinë znj. Caroline Ziadeh - Kërkesë për ndërtimin e Stadiumit të Qytetit	1
8	Përfaqësuesja Speciale e Sekretariatit të përgjithshëm të OKB-së në Prishtinë znj. Caroline Ziadeh - Kërkesë për vazhdimin e Kontratës me UNICEF-in për Menaxhimin e Qërdhes	1
9	Përfaqësuesja Speciale e Sekretariatit të përgjithshëm të OKB-së në Prishtinë znj. Caroline Ziadeh - Kërkesë për vazhdimin e aktiviteteve të UNICEF-it në Komunën e Dragashit	1
10	Ambasadorin e BE-së në Kosovë z.Tomas Szunyog - Kërkesë për financimin e Ujësjellësit për Komunën e Dragashit	1
11	Ambasadorin e BE-së në Kosovë z.Tomas Szunyog - Kërkesë për financimin e Fabrikës së Ujit (Implantit) për 15 fshatra	1
12	Ambasadorin e BE-së në Kosovë z.Tomas Szunyog - Kërkesë për ndërtimin e rrugës përgjatë Lumit Pllavë që lidh Komunën e Dragashit me Bashkinë e Kukësit në Republikën e Shqipërisë	1

13	Ambasadën e Suedisë në Kosovë – Kërkesë për financimin e ndërtimit të ujësjellësit për Komunën e Dragashit (16 fshatra dhe qyteza)	1
14	Komuna Winterthur - Kërkesë për financimin e ndërtimit të ujësjellësit për Komunën e Dragashit (16 fshatra dhe qyteza)	1
15	Komuna Selçuklu – Kërkesë për financimin me 2 kombi busë për nevojat e nxënësve nga Komuniteti Jo shumicë	1
16	KFOR Comand West – Kërkesë për furnizim me pajisje për njësinë e zjarrfikësve në Komunën e Dragashit	1
17	KFOR-i Turk – Kërkesë për financimin e materialeve ndërtimore për Shkollën Filllore “Zenuni” Brod	1
18	KFOR-i Turk – Kërkesë për hapjen e rrugës bujqësore Globocicë Zlipotok,	1
19	KFOR-i Turk – Kërkesë për hapjen e rrugës bujqësore në f.sh. Brezne	1
20	KFOR-i Turk – Kërkesë për trasimin e rrugës nga varrezat e Beqiraje deri te “Rrafshinat” në f.sh. Bresanë	1
21	KFOR-i Turk – Kërkesë për Trasimin e rrugës bujqësore – Mali i midis	1
22	z. Ratislav Kostilnik – shef i zyrës ndërlidhëse të Republikës Sllovaqe në Kosovë – Kërkesë për ndërtimin e parkut në Dragash	1
23	KEDS Sh.A. Prizren – Kërkesë për vendosjen e njehsorit elektrik në f.sh. Brezne	1
24	KEDS Prishtinë për Drejtorin e Teknikës – Kërkesë për Rehabilitimin teknik të rrjetit të energjisë elektrike në zonën e Komunës së Dragashit	1
	Gjithsejtë	24
	Shkresa të ndryshme...	
1	Njoftime	13
2	Raporte	8
3	Urdhëresa	2
4	Letër konfirmimi dhe mbështetje	11
5	Ftesa	2
6	Deklarata	3
7	Autorizime për listën e pagave	2
8	Autorizime të ndryshme	7
9	Agjenda për debat me qytetaret e fshatrave	2
10	Përgjigje në kërkesa dhe ankesa	16
11	Plani i punës	3
12	Konfirmime d.thesarit	9
13	Rekomandime	1
14	Procesverbale për furnizim me karburante KFOR-Turk	2

15	Thirrje publike OJQ-ve	4
16	Anulime të raporteve	20
17	Tabela e shpenzimeve 2020-2021	1
18	Parashtrisa në vendimet gjyqësore	1
19	Forma të autorizimit për listën e pagave	1
20	Kërkesa për rekrutim punësim + 1 Raport	55 + 1
21	Padi ministrive	2
22	Ankesa për MAPL-në	1
23	Aplikacion për projektet për sigurimin e autobusit për nxënës	1
24	Zotim për transferim të mjeteve sipas marrëveshjes	1
25	Aneks kontratë për shërbime postare	1
26	Formular për aplikim trajnim profesional	1
27	Lëndë të ceduara	105
28	Pezulluar	7
29	Hedhur Poshtë	2
30	Anuluar	4
31	Pranuar	5
	Gjithsejtë	294
	Vendimet e zyrës së prokurimit IV	
1	Menaxhera të projekteve	183
2	Pranime Teknike	171
3	Shpallje tenderi	132
4	Punë Shtesë	4
5	Ankand	2
6	Zyrtar autorizues	8
7	Udhëzim	1
	Gjithsejtë	501
1	Takime Publike	2
2	Dëgjime Publike me qytetar nëpër fshatra dhe në Sallën e Kuvendit	29
	Gjithsejtë	31

Pjesë përbërëse e Raportit të Kryetarit janë edhe Raportet dhe Planet e Punës së Drejtorive të Komunës

Janar 2023



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA- REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA DRAGASH – OPŠTINA DRAGASH- MUNICIPALITY OF DRAGASH



Drejtoria e Administratës

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
Komuna e Dragashit
Opština Dragaš

02 Nr. Br. 020/01-1159/23
16.01.2023
Dragash - Dragaš

RAPORTI VJETOR I PUNËS

01/01/2022 – 31/12/2022



Vetim Ramadani
Drejtor i Administratës

Janar, 2023



Raporti vjetor i hartuar nga Drejtoria për Administratë të Përgjithshme ka për qëllim që të pasqyrojë aktivitetet dhe punën që është zhvilluar gjatë vitit 2022 në sektorët që i përkasin kësaj drejtorie si dhe informimin e drejtë të qytetarëve, institucioneve komunale, shoqërisë civile dhe të gjitha palëve që janë të interesuara për punën e kryer gjatë këtij viti.

Marrë parasyshë faktin se Drejtoria e Administratës është ura lidhëse e shërbimeve të institucioneve lokale me qytetarët dhe institucionet qendrore, shërbimi i Administratës Komunale ka qenë i përkushtuar në ofrimin e shërbimeve sa më cilësore. Kjo drejtori ka bërë ushtrimin dhe zbatimin e shërbimeve të përgjithshme administrative për organet administrative dhe organet tjera komunale dhe ofrimin e shërbimeve për qytetarët e Komunës së Dragashit konform ligjeve, udhëzimeve administrative dhe rregulloreve në fuqi, gjatë vitit 2022. Shërbimet të cilat komuna u ofron qytetarëve të saj bazohen në nevojat dhe kërkesat e qytetarëve duke qenë në harmoni të plotë me ligjet udhëzimet administrative të Republikës së Kosovës..

Drejtoria për Administratë të Përgjithshme punën e saj e bazon brenda kornizave ligjore të cilat janë në fuqi si:

- Ligji për Vetëqeverisjen Lokale,
- Ligji mbi Shërbimin Civil,
- Ligjin mbi Librat Amzë,
- Statutin e Komunës,
- Rregulloret komunale,
- Urdhëresat dhe Udhëzimet.

Drejtoria për Administratë të përgjithshme është kujdesur që gjatë vitit 2022 të krijojë kushte më të përshtatshme të punës për zyrtarët në mënyrë që shërbimet të jenë në nivel të kënaqur për qytetarët e Komunës së Dragashit.

Nga buxheti i Drejtorisë për Administratë të përgjithshme ashtu siç janë planifikuar mjetet kemi arritur që ti realizojmë qëllimet duke mbuluar:

- Pagat për stafin që i përkasin Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme,
- Shërbimi i telefonisë mobile,
- Shërbimet postare,
- Shërbimet e shtypjes (printim dhe skanim),
- Shërbimet e ujësjellësit,
- Shërbimi i mirëmbajtjes së veturave zyrtare në kuadër të DAP,
- Furnizimi me inventar për nevojat e Komunës së Dragashit,
- Furnizim me material hargjues-higjienik për nevojat e Komunës së Dragashit,
- Furnizim me derivate për nevojat e automjeteve zyrtare,
- Rregullimi dhe mirëmbajtja e autoparkut dhe hapësirave për parking,
- Përmbushja e nevojave të tjera rreth objektit të Komunës së Dragashit,



- Bashkëpunim me drejtoritë e tjera për realizimin e projekteve.

Të gjitha shpenzimet e Drejtorisë për Administratë të përgjithshme janë të paraqitura edhe në raportet financiare.

Drejtorati i Administratës së Përgjithshme në aspektin organizativ ndahet në disa sektorë që do të paraqiten si në vijim:

- I. Sektori i Gjendjes Civile (Ofiqaria);**
- II. Zyra për Shërbime të Qytetarëve dhe Arkivi;**
- III. Zyra e Prokurimit;**
- IV. Shërbimet Teknike;**
- V. Njësia për IT.**



I. Sektori i Gjendjes Civile (Ofiqaria)

Shërbimi i Gjendjes Civile në Komunën e Dragashit gjatë periudhës Janar-Dhjetor të vitit 2020 ka arritur që të jetë shumë efikas dhe ti shërbejë të gjithë qytetarët në kohë optimale. Gjatë kësaj periudhe ky shërbim në kuadër të kompetencave të tij kryen një sërë aktivitetesh që do ti paraqesim në vazhdim të këtij raporti.

Me punën e zyrtarëve të Gjendjes Civile arrihet që të lëshohen një numër i konsiderueshëm i dokumenteve nga ky sektor ku varion nga 30,000 sosh deri në 35,000 sosh brenda një viti. Kjo tregon që shërbimi për marrjen e një dokumenti të nevojshëm për qytetarët është shumë i shpejtë, efikas, i qëndrueshëm dhe i përgjegjshëm me kapacitetet aktuale që kemi.

Ashtu siq edhe e thekson statuti i Komunës sonë, Shërbimi i Gjendjes Civile (Ofiqaria) është i organizuar në pesë lokacione të cilat gjenden si në vijim:

- Dragash,
- Bresanë,
- Llapushnik,
- Krushevë,
- Brod.

Këto pesë lokacione janë të vendosura në këtë mënyrë me qëllim që qytetarët ti kenë sa më afër Shërbimet e Gjendjes Civile ku mbulohet i gjithë territori i Komunës sonë.

Gjatë këtij viti jemi ballafaquar me rritje të kërkesave për shërbimet që ofron Zyra e Gjendjes Civile dhe me ardhjen e bashkëatdhetarëve tanë të cilët jetojnë jashtë Republikës së Kosovës, nga data 29.07.2022 deri me datën 26.09.2022 ky shërbim ka punuar edhe gjatë fundjavës (ditës së shtunë) me orar nga ora 09:00 deri në ora 13:00 ndërsa vlen të theksohet se edhe gjatë ditëve të punës (e hënë-e premte) është punuar me orar të zgjatur.

Drejtoria e Administratës është kujdesur që të sigurojë kushte të punës për të gjithë zyrtarët duke i pajisur me paisje kompjuterike moderne në mënyrë që të rritet eficaenca e shërbimeve.

Më poshtë do ta paraqesim në mënyrë tabelare punën e Shërbimit të Gjendjes Civile ku në detaje janë të paraqitura statistikat varësishtë nga lloji i çertifikatës, regjistrimet në regjistrat themeltar dhe regjistrimet në regjistrat e veqantë nga bota e jashtme.



- ❖ Për periudhën Janar –Dhjetor të vitit 2022 janë lëshuar këto dokumente të Gjendjes Civile:

Nr.	Lloji i çertifikates	Brenda vendit	Jashtë vendit	Totali
1.	Certifikate lindje	2307	3386	5693
2.	Ekstrakt lindje	14694	3019	17713
3.	Certifikate martesë	1750	1236	2986
4.	Deklaratë e bashkësisë familjare	717	764	1481
5.	Certifikate vendbanimi	816	361	1177
6.	Certifikate e shtetësisë	157	145	302
7.	Certifikate e gjendjes martesore	363	224	587
8.	Vertetim nga arkiva	233	153	386
9.	Certifikate vdekje	948	296	1244
Totali				31.569

Dëshmi vdekje (Aktvdekje).....197

- ❖ Regjistrimet në regjistrat themeltar:

Nr.	Lloji	Sasia
1.	Aktet e Lindjes	14
2.	Aktet e Martesës	268
3.	Akte të Vdekjes	170

- ❖ Regjistrimet ne regjistrat e veçantë nga bota e jashtme:

Nr.	Lloji	Sasia
1.	Aktet e Lindjes	584
2.	Aktet e Martesës	170
3.	Akte të Vdekjes	184

-Kërkesa për lirim nga shtetësia e RKS kanë aplikuar 34 persona.

-Kërkesa për fitimin e shtetësisë se RKS kanë aplikuar 97 persona.

-Shtetësinë me Vendim të Divizionit për shtetësi e kanë fituar 35 ,kurse në bazë të Nenit 31 dhe Nenit 32 të LIGJI NR. 04/L-215 PËR SHTETËSINË E KOSOVËS jane regjistruar 26 persona.

-Shkurorëzime janë regjistruar 134 .



Të hyrat e inkasuara nga Shërbimi i Gjendjes Civile në periudhën **01.01.2022** deri **31.12.2022** dhe të dorëzuara tek Zyrtari i Pasurisë së Komunës kanë vlerën prej **38,596.00€**.

Vlen të theksohet se të gjithë zyrtarët e këtij shërbimi në total kanë procesuar **24,811 lëndë**.

Me hyrjen në fuqi të Udhëzimit Administrativ NR.01/2022 për dokumentet e Gjendjes Civile edhe shërbimi ynë ka bërë përgatitjet në kohë dhe me datë **28.02.2022 kemi filluar me programin e ri të RQGJC me versionin QR Code**, kurse me programin e ri të pagesave kemi filluar me datë 01.04.2022.

II. Zyra për Shërbime të Qytetarëve dhe Arkivi

Zyra për shërbim të Qytetarëve u shërben qytetarëve për t'u informuar me procedurat e nevojshme për kryerjen e punëve administrative në harmoni me dispozitat ligjore për kryerjen e shërbimeve të ndryshme nga organet e administratës komunale. Zhvillimi i procedurave bëhet si në vijim: fillimisht paraqitet kërkesa, protokolohehet, skenohet, ruhet në sistemin e INTRANET-it dhe më pas shpërndahet me anë të librave të brendshëm dhe elektronikë deri tek drejtoritë përkatëse nga ana e personit të autorizuar për kryerjen e këtij shërbimi. Protokoli për këtë procedurë administrative mbahet në mënyrë elektronike si dhe me shkrim, njëherit të gjitha kërkesat, dokumentet dhe shkresat të cilat janë të protokoluara, skenohen dhe më pas përcillen në ministri dhe në drejtori përkatëse me anë të sistemit të INTRANET-it. Kështu në çdo moment mund të përcjellim në këtë sistem azhurimet e shërbimeve përbrenda komunës. Në periudhën kohore 01.01.2022 – 31.12.2022 në këtë zyrë janë regjistruar gjithsejt **39,219 lëndë**.

Në këtë zyre gjithashtu kryhen edhe pagesat e shërbimeve komunale sipas Rregullores mbi Taksat Komunale për shërbime të caktuara. Gjatë vitit 2022 janë inkasuar gjithsejt **12,961.00 €**.



III. Zyra e Prokurimit

Zyra e Prokurimit funksionon në përputhje me Ligjin e Prokurimit Publik të Republikës së Kosovës dhe akteve të tjera që janë nxjerrë nga ky Ligj,

Kjo zyrë, edhe pse me mungesë stafi konform nevojave, gjatë vitit 2022 ka qenë mjaftë efikase duke arritur që të kryejë të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë me një dinamikë të jashtëzakonshme duke realizuar kështu me sukses buxhetin e planifikuar për këtë vit.

Të gjitha projektet, duke përfshirë projektet e investimeve kapitale, projektet për blerjen e mallrave dhe shërbimeve si dhe për nevoja të tjera të të gjitha sektorëve të Komunës së Dragashit kemi arritur t'i realizojmë me sukses dhe në kohë. Në vazhdim do të paraqesim punët që ka kryer kjo zyrë duke pasur bashkëpunim të ngushtë me të gjitha drejtoritë përkatëse në mënyrë që të realizohen të gjitha objektivat e parapara për këtë vit.

Gjatë vitit 2022 kjo zyrë ka zhvilluar gjithsejt **167 aktivitete prokurimi** me një vlerë totale të parashikuar të kontratave prej 5,714,448.57€ dhe si rezultat, realizimi i projekteve të investimeve kapitale, mallra dhe shërbimeve arrin shumën prej **4,759,189.98€**, shumë kjo e cila iu është bërë në formë pagese Operatorëve Ekonomik (OE) të ndryshëm.

Kjo vlerë e paraqitur në këtë raport është realizur me një numër të madh operatorësh ekonomik, të cilët pavarësishtë ndryshimeve globale të rritjes së çmimeve kanë marrë pjesë përmes ofertimit në procedurat e iniciuara nga ana e Komunës së Dragashit.

Me qëllim ngritjen e transparencës dhe llogaridhënies, të gjitha kontratat e nënshkuara me Operatorët Ekonomikë janë publikuar edhe në web faqen e Komunës së Dragashit në mënyrë që të gjithë qytetarët apo grupet e ndryshme të interesuara për aktivitetin e Zyrës së Prokurimit të kenë qasje dhe të përcjellin nga afër punën e kësaj zyreje dhe qeverisjes lokale në përgjithësi.



IV. Shërbimet Teknike

Në kuadër të këtij shërbimi janë të përfshira këto njësi:

1. **Autoparku i Komunës;**
2. **Rojet e objekteve Komunale;**
3. **Shërbimi i pastrimit të objekteve Komunale;**
4. **Depo e Komunës;**

Autoparku: Ky shërbim gjatë vitit 2022 ka qenë i organizuar me katër punonjës të stafit teknik, ku dy nga këta janë vozitës të autobusëve të komunës dhe dy të tjerë vozitës të veturave të Administratës. Kështu që gjatë këtij viti kanë funksionuar dy autobusë për bartjen e nxënësve të shkollave të mesme të ulëta si dhe plotësimi i nevojave të ndryshme të paraqitura kohë pas kohe sipas kërkesave specifike të shkollave, klubeve të futbollit dhe shoqërisë civile, ndërsa veturat zyrtare të komunës janë shfrytëzuar nga zyrtarët komunal të cilët për nevoja të komunës kanë udhëtuar brenda komunës, regjionit, jashtë regjionit dhe jashtë vendit, varësisht nga ftesat apo punët zyrtare që janë paraqitur nga zyrtarët e drejtorive të ndryshme.

Zyrtarët e autoparkut të komunës janë kujdesur për evitimin e problemeve të ndryshme të veturave dhe autobusëve zyrtarë të komunës ku janë angazhuar në përcjelljen e afateve të servisimit të rregullt të tyre, sigurimin dhe regjistrimin e të gjitha automjeteve zyrtare duke respektuar afatet kohore në mënyrë që automjetet të jenë sa më funksionale dhe në gjendje gatishmërie për të iu përgjigjur nevojave dhe kërkesave të drejtorive të ndryshme brenda komunës dhe jashtë saj.

Sigurimi i Objekteve Komunale: Ky shërbim kujdeset për sigurinë e objekteve komunale gjatë natës. Shërbimi është i organizuar me tre puntorë të cilët janë përgjegjës për sigurinë nga rreziqet e ndryshme që mund të paraqiten në objektin e Komunës së Dragashit dhe objektin e ZGJC- Dragash. Gjatë këtij viti nuk kemi pasur kurrfarë vështirësish rreth mirëmbajtjes dhe ruajtjes së objekteve Komunale.

Pastruesit e objektit: Ky shërbim është përgjegjës për mirëmbajtjen dhe pastrimin e objektit të komunës, duke përfshirë të gjitha zyret dhe hapsirat që janë brenda objektit të Komunës dhe të gjitha hapësirat që gjenden në objektin e ZGJC-Dragash. Shërbimi i pastrimit funksionon aktualisht me tre puntorë të cilët furnizohen në bazë javore me material higjienik në deponë e



komunës, duke siguruar ambiente pune të pastërta për zyrtarët komunal dhe ambiente shërbimi sa më të pastërta ndaj qytetarëve.

Depo e Komunës: Shërbimi në depon e Komunës është i organizuar me një zyrtar të depos-depoist. Ky shërbim është përgjegjës për pranimin e mallrave shpenzues, menaxhimin e tyre dhe shpërndarjen sipas kërkesave të personelit të Komunës së Dragashit.

Ky shërbim gjatë vitit 2022 ka qenë shumë efikas duke arritur të plotësojë kërkesat dhe nevojat për furnizim me material shpenzues (zyrtar dhe higjienik) për të gjithë personelin e Komunës.

V. Njësia e Teknologjisë Informative

Njësia për Teknologji Informative është zyrë shumë dinamike dhe konsiderohet si kyçe në punët Administrativo-teknike. Kjo zyrë e ka këtë rëndësi për shkak të vizionit dhe realizimit të përditshëm të një qeverisje elektronike, duke u kujdesur që planet të realizohen në vepra me përdorim të teknologjisë moderne softwerike dhe hardwerike.

Kjo zyrë gjatë kësaj periudhe ka zhvilluar në baza ditore aktivitetet si në vijim:

- Intervenime rutine nëpër kompjuterë të punëtorëve të administratës komunale të cilat kanë pasur nevojë për ruajtjen e shënimeve, formatizimin e tyre, intervenime softwerike, etj;
- Mirëmbajtjen e sistemit të INTRANET-it;
- Mirëmbajtja e sistemit elektronik të arkivimit;
- Mirëmbajtja e sistemit të e-Pasuria;
- Kontrollimi dhe mirëmbajtja e përditshme e serverëve komunal;
- Puna e përditshme në web faqen e Komunës;
- Mirëmbajtja e llogarive të emailit zyrtar për tërë zyrtarët komunal;
- Krijimin e shfrytëzuesve të ndryshëm në sistemin e INTRANETI-it dhe në domenin qeveritar;
- Punë të ndryshme sipas kërkesave në fushën e teknologjisë informative;
- Takime të ndryshme me ftesë nga Ministria dhe Kolegjiumi i IT-ve në kuadër të AKK;
- Asistenca në mbarëvajtjen e mbledhjeve të asamblesë komunale, lidhja direkte në kanalën zyrtar në youtube, dhe plasimi i gjirimeve në web faqen e komunës;
- Intervenime në teren dhe Zyret e Gjendjes Civile.



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA- REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA DRAGASH – OPŠTINA DRAGASH- MUNICIPALITY OF DRAGASH



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
Komuna e Dragashit
Opština Dragash

02 Nr. Br. 020/09-1461/23
16-01-2023
Dragash - Dragash

DREJTORIA E ADMINISTRATËS

PLANI I PUNËS

2023

Janar, 2023



HYRJE

Duke u bazuar ne Ligjin Nr.03/L-040 mbi Vetëqeverisjen Lokale, Ligjin Nr.03/L-149 mbi Sherbimin Civil, Ligjin Nr.04/L-003 për Gjendjen Civile, Udhëzimeve Administrative, Statutin e Komunës, Rregulloret Komunale, Urdhëresat dhe Udhëzimet komunale që specifikojnë rregullat dhe modalitetet e aplikimit të Ligjit dhe veprimit administrativ, Drejtoria e Administratës Komunale do të ushtrojë aktivitetin në të gjithë sektorët e saj organizativ si në vijim:

- Sektori i Gjendjes Civile (Ofiqaria).
- Zyra për shërbime të qytetarëve dhe arkivi.
- Zyra e prokurimit.
- Shërbimet teknike.
- Njësia për IT.

Për te siguruar një punë efikase Drejtoria e Administratës përgatitë Planin e Punës për vitin 2023, në të cilin plan do të paraqiten objektivat dhe dinamika e arritjes se këtyre objektiveve për këtë vit.

Qëllimi i këtij plani është të përgatisim një plan menagjimi të bazuar në kapacitete organizative dhe teknike, përmirësim të kushteve të punës, performancës së deritashme dhe shfrytëzimit sa më të mirë të kapaciteteve që ka kjo drejtori me qëllim rritjen e nivelit të performancës dhe ofrimit të shërbimeve për qytetarët.

Zbatimi i përvojës që është krijuar nga stafi i sektorëve dhe mundësia e përmirësimit të shërbimit për secilin sektorë do të jetë sfidë dhe objektivi ynë i përbashkët.



RËNDËSIA DHE HAPAT

Rëndësia e këtij plani qëndron në mundësinë e eliminimit të dobësive që kanë përcjellur Administratën Komunale nga viti paraprak dhe që kanë ndikuar drejtëpërdrejtë në performancë. Menagjimi i bazuar në performancë është një qasje që në mënyrë sistematike mundëson përmirësimin e performancës përmes një procesi të vazhdueshëm të vendosjes së objektivave, matjes së performancës përmes grumbullimit, analizimit dhe rishikimit të të dhënave.

Vlerësojmë se Plani Vjetor i Punës duhet të bazohet në performancë e jo në numër të aktiviteteve, sepse rezultatet janë ato që flasin.

Dinamika e punës sipas këtij plani duhet të përcillet çdo javë me qëllim që mos të ketë ngecje në përmbushjen e objektivave, por në mënyrë sistematike të përcillen të arriturat të përcaktuara në këtë plan.

Problemet nga viti paraprak siq është mungesa e hapësirave të nevojshme dhe kushteve optimale të punës për stafin e drejtorisë ka ndikuar në forma të ndryshme edhe në rezultatet e punës. Edhe më tutje sfida në vete paraqet digjitalizimi i shërbimeve administrative dhe rregullimi i statusit të zgjidhjes së lëndëve.

Sektori i Gjendjes Civile

❖ Objektivat

1. Regjistrimi i lindjeve, martesave dhe vdekjeve brenda dhe jashtë vendit

1.1 Dhënia e infomatave korrekte dhe infomimi për procedurat e regjistrimit të lindjeve, martesave dhe vdekjeve.

1.2 Perpjekja që qytetarët të jenë të kënaqur me kohën dhe shërbimet e mira.

2. Lëshimi i dokumenteve të Gjendjs Civile

2.1 Lëshimi i dokumenteve të GJC në kohë optimale dhe tani me UA të MPB nr.01/2022 lëshohen me QR Code që nënkupton vërtetimin e autenticitetit , duke zbatuar legjislacionin në fuqi të RKS.



3. Përcjellja e punës dhe aktiviteteve të të gjithë zyrtarëve të sektorit të Gjendjes Civile.

3.1. Punë efikase, shërbime dhe rezultate më të mira.

3.2 Përmirësim i kushteve të punës, furnizimi i zyrave me orman metalik, karrige dhe tavolina të punës dhe stol qëndrimi për palët si dhe vendosja e një printeri multifunksional në shërbim të qytetarëve gjatë sezonës kur ka fluks më të madh të qytetarëve.

4. Bashkëpunimi i ngushtë me ministritë përkatëse MPB, MAPL, MAP si dhe departamentet që operojnë në këto ministri.

4.1 Bashkëpunim me DRGJC –ARC në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

4.2 Bashkëpunim me sektorët e Teknologjisë Informative për programet që përcjellin punën dhe veprimtarinë tonë.

4.3. Për vitin 2023 jemi të përgatitur që të zbatojmë çdo direktivë, udhëzim nga ARC-MPB sa i përketë kërkesave që vijnë në kuadër të liberalizimit të vizave.

5. Raportimi i punës në sektorin e Gjendjes Civile

5.1 Raportet javore, mujore dhe vjetore në forma tabelare me statistikat përkatëse për lindjet, martesat dhe vdekjet. Po ashtu me këto të dhëna njoftohet edhe Enti i Statistikës së Republikës së Kosovës.

6. Zbatimi i ligjeve dhe udhëzimeve të reja në sektorin e Gjendjes Civile.

6.1 Përcjellja në kohë e njoftimeve dhe informacioneve tek zyrtarët e Gjendjes Civile.

Zyra për Shërbime të Qytetarëve dhe Arkivi

❖ Objektivat

- Zyra për shërbimin e qytetarëve do të funksionojë si pjesë e strukturës organizative të administratës së komunës.
- Çdo shërbim publik që ofron komuna, duhet të protokollohet përmes zyrës dhe secila drejtori duhet të jetë e lidhur me këtë zyrë.
- Zyra do të pranon dhe procedon për shqyrtim dhe vendosje kërkesat e qytetarëve në drejtoritë komunale dhe njësitë organizative brenda drejtorive.
- Zyra ofron shërbime tjera si vijon: shërbimet e arkivës, shërbimet e gjendjes civile, tatimin në pronë, shërbimet kadastrale dhe të gjitha shërbimet tjera.
- Zyra duhet të këshillojë dhe të ndihmojë në çështjet teknike-administrative për mënyrën e plotësimit të kërkesave.
- Do të bëjë pranimin dhe regjistrimin e kërkesave.
- Do të bëjë mbajtjen e dosjeve, statistikave të kërkesave të paraqitura nga qytetarët.



- Gjithashtu do të protokollojë të gjitha aktet e nxjerra nga organet e komunës.
- Do të vazhdojë implementimin dhe përditësimin e të dhënave në kohë reale në sistemin e INTRANET-it.

Zyra e Prokurimit Publik

Kjo zyrë pos realizimit të buxhetit të aprovuar nga Asambleja Komunale për investime kapitale dhe shpenzime të ndryshme që ka komuna gjithashtu do të përkujdeset për ofrimin dhe procesimin e të gjitha kërkesave dhe nevojave që vijnë nga drejtoritë komunale.

Në mënyrë që projektet të realizohen me sukses për ta arritur një përqindje të konsiderueshme të realizimit të buxhetit që është paraparë për vitin 2023, zyra e Prokurimit do të bashkëpunojë sa më tepër me të gjitha drejtoritë si në projektet e investimeve kapitale poashtu edhe me furnizimet e nevojshme për organet e administratës komunale.

Po ashtu, me qëllim ngritjen e transparencës e gjithë veprimtaria e zyrës së prokurimit do të publikohet në web faqen e komunës si dhe në platformën eProkurimi.

Shërbimet Teknike

❖ Njësia e Autoparkut Komunal:

Njësia e autoparkut të komunës është planifikuar në atë mënyrë që:

- Të gjithë përdoruesit e automjeteve duhet që të përdorin automjetet zyrtare në mënyrë sa më ekonomike dhe efikase.
- Do të bëhet mirëmbajtja e simboleve apo shenjave identifikuese të Komunës së Dragashit tek automjetet zyrtare.
- Do të bëhet servisimi i rregullt i automjeteve në mënyrë që automjetet të jenë vazhdimisht në dispozicion për kryerjen e detyrave zyrtare.
- Varësisht nga kostoja, do të shqyrtohet mundësia e paisjes me GPS e të gjitha automjeteve zyrtare.



❖ **Sigurimi i Objekteve Komunale:**

Sigurimi i objektit të Komunës do të kryej punën sipas aktivitetit si në vijim:

- Do të jetë në gjendje që gjatë natës të kujdeset për objektin e Komunës.
- Do të përcjellë sigurinë e objektit.
- Do të mundohet që të parandalojë rreziqet që mund të paraqiten gjatë natës.
- Do të mbajë evidencë për hyrje-daljen e zyrtarëve gjatë natës.
- Do të adresojë problemet eventuale që mund të paraqiten gjatë punës.

❖ **Shërbimi i pastrimit:**

Ky shërbim do të kujdeset që hapsirat e objektit të Komunës të jenë të pastërta duke u kujdesur për secilën hapsirë të komunës dhe të objektit të ZGJC-Dragash.

Gjithashtu nevojat për mjete pastrimi do të ju sigurohen në bazë të kërkesave të tyre pranë Depos së Komunës dhe konform kontratave të cilat organizohen nga Zyra e Prokurimit.


Njësia e Teknologjisë Informativë

Objektivat apo planet e njësisë së IT-së për vitin 2023 janë si në vijim:

- Mirëmbajtja e paisjeve teknologjike për të gjithë punëtorët e Administratës.
- Zhvendosja e lokacionit të dhomës së serverëve(Server Room) në një hapsirë më të madhe.
- Përmirësimi i infrastrukturës së rrjetit, hartimi i planit detal të LAN-it dhe implementimi i projektit.
- Sigurimi i një File Server-i të ri.
- Asistencë në implementimin e sistemit të INTRANET-it për të gjithë punëtorët e Administratës Komunale.

Datë: 16.01.2023




Vetim Ramadani
Drejtor i Drejtorisë së Administratës



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVO-
REPUBLIC OF KOSOVO

KUVENDI KOMUNAL DRAGASH – SKUPŠTINA OPŠTINE DRAGAŠ-
MUNICIPALITY OF DRAGASH

**DREJTORIA E BUJQËSISË, TURIZMIT,
ZHVILLIMIT RURAL DHE INSPEKSIONIT**

RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2022

DHE

PLANI I PUNËS PËR VITIN 2023



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
REPUBLIC OF KOSOVO

Kuvendi Komunal Dragash – Skupština Opštine Dragaš – Municipality of Dragash
Drejtoria për Bujqësi, Inspeksion, Pylltari ,Turizëm dhe Zhvillim Rural
Direktorijati za Poljoprivredu, Inspekciju, Šumarstvo, Turizam i Ruralni Razvoj
Directorate for Agriculture, Inspections, Forestry, Tourism and Rural Development

DATA/DATUM:	19.01.2023
REFERENCE-E:	09/Br.
PËR/ZA/TO:	Kancelariji Predsednika Opštine Dragaš
CC:	
PERMES/PREKO/THROUGH:	Skupšinska služba prevođenja
NGA/OD/FROM:	Drejtoria për Bujqësi, Inspeksion, Pylltari ,Turizëm dhe ZhvillimRural Drejtore: Erdjan Limançe
TEMA/SUBJEKT/SUBJECT:	RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2022

TË NDERUAR! Në bazë të dispozitave ligjore në fuqi për rolin dhe kompetencat e Drejtorisë, Planin e Punës dhe detyrat specifike të përmbajtura për vitin 2022, si aktivitetet bazë dhe puna e Drejtorisë përkatëse gjatë vitit 2022 u zhvilluan si më poshtë.

SEKSIONI PËR BUJQËSI, TURIZËM DHE ZHVILLIM RURAL:

Bashkpunimi me MBPZHR: Duke pasur parasysh se politika agrare shtetërore definohet në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Drejtorati për Bujqësi, Inspektion, Turizëm, Pylltari dhe Zhvillim Rural, përmes Seksionit për Bujqësi dhe Turizëm, ka realizuar bashkëpunim të plotë me MBPZHR dhe zyrën regjionale të MBPZHR në Prizren, për t'u siguruar fermerëve rrugën më të shkurtër të shërbimeve dhe përfitimit të mjeteve të pagesës së drejtpërdrejtë (subvencioneve), si dhe mjeteve të Grantit për përparimin e bujqësisë. Projekti ka paraparë subvencione e prodhimitarisë blegëtorale (lopë mjelëse dhe dele), bletarisë, pemëtarisë, mbjellja e kulturave agrare si dhe produktet e qumështit.

Mjetet e Grantit kanë qenë të destinuara për rikonstruktimin dhe ndërtimin e fermave për lopë mjelëse dhe dele, për ferma të pulave vojse, përkatësisht vezëve të konsumit dhe prodhimitari blegëtorale, si dhe mjete për prodhimitari bimore, siç është ndërtimi i serave, përkatësisht prodhimitaria e perimeve në hapësira të mbyllura, themelimi i plantacioneve të pemëve me kulturën-mollë, si dhe plantacioneve të dredhëzave, manaferrave etj.

Subvencione dhe grantet:

Prodhimtaria e deleve: Ka përfunduar projekti i subvencionimit në prodhimtarinë e deleve, për dele kanë aplikuar **35 fermerë**, përkatësisht **9796 dele** dhe për dhitë **3 fermerë** përkatësisht **82 dhi**.

Prodhimtaria blegëtorale: Është kryer projekti i subvencioneve në prodhimtarinë blegëtorale, përkatësisht për lopë mjelëse, kanë aplikuar **149 fermerë** me fondin blegëtoral prej **1716 frymëve**.

Ka pasur **40** ferma me prodhim të kombinuar gjedhe - dele - fruta dhe fusha.

Prodhimtaria e bletarisë: Ka përfunduar projekti i subvencionimit në prodhimtarinë e bletarisë, kanë aplikuar **52 bletarë**, përkatësisht **3044 koshere bletësh**.

Prodhimtaria e vezëve: Ka përfunduar projekti i subvencionimit për pulat vojse, në prodhimtarinë për pula vojse kanë aplikuar **1 fermerë**, përkatësisht **4800 pula vojse** dhe për thëllëza **3 fermerë**, përkatësisht **950 thëllëza vojse**.

Përpunimi i qumështit: Qumështoret lokale për **gjashtë muaj të vitit 2022**, kanë grumbulluar rreth **984187 litra qumësht** prej **56 fermerëve** ..

Prodhimtaria e pemëve: Subvencionet për pemë **24 fermerë**, për **11.20 ha**.

Është bërë bashkëpunimi i plotë me MBPZHR

Përpunimi i informacioneve dhe njoftimeve për fermerët lidhur me pjesëmarrjen në konkurse: ndihma dhe informatat u janë dhënë fermerëve për grumbullimin e dokumentacionit të caktuar për konkurs.

Bashkëpunimi me zyrën rajonale të Bujqësisë në Prizren: Lajmërimet dhe mbështetja për konkurs në projektet e Granteve dhe Subvencioneve (bletë, lopë qumështore, dele, dhi), organizimi i seminarit se si të bëhet një biznes plan për pjesëmarrje në Grante.

Këshilla për fermerë dhe grupe të fermerëve: Organizimi i trajnimeve për fermerët në prodhimtarinë blegëtorale. Aktivitetet bëhen në teren si dhe në hapësirat e sektorit.

Bashkëpunimi me CARTIAS-in: Marrëveshje lidhur me vazhdimin e bashkëpunimit për projekte të reja për vitin 2023;

Bashkëpunimi me IADK-në: Marrëveshje për vazhdimin e bashkëpunimit për vitin 2023;

Bashkëpunimi me OJQ-të komunale: Problemet dhe rreziqet që e bëjnë të pamundur funksionimin sipas vëzhgimit të liderëve, si dhe vëzhgimi i shërbimit që OJQ-të lokale veprojnë ashtu siç ata e gjykojnë të përshtatshme, ku nuk ka asnjë justifikim për ta, nuk kanë pasur aktivitete të veçanta në vitin e kaluar.

Vizitat e qumshoreve për grumbullimi dhe përpunimin e qumshtit:

Organizimi cilësor i kapaciteteve blerëse dhe përpunuese, arriti standarde të mira, shprehu nevojë për pagesa të primeve të qumështit si subvencione nga ana e Ministrisë. Vërehet një ngritje e blerjes së qumështit për 6 muajt e kaluar krahasuar me vitin paraprak;

Vizitat e fermerëve në pikat sezonale (verore):

Problemet mbetën të njëjta, mbështetja e autoriteteve mungonte, kushtet sanitare dhe higjienike janë ende shumë të këqija.

Takimet dhe aktivitetet me bletarët: Regjistrimi i bletarëve, janë indentifikuar problemet dhe roli i shoqatës dhe Drejtoratit për tejkalimin gjendjes aktuale (gjendja shëndetësore e bletëve). Në bazë të vërejtjeve të të gjithë bletarëve ka shqetësim për mbijetesë të këtijë komuniteti. Probleme të dukshme me gjetjen e ilaçeve dhe ushqimit për shkak të lëvizjes së kufizuar të fermerëve.

Bashkëpunimi dhe mbikëqyrja e të mbjellurave pranverore dhe vjeshtore: Prill, Maj, Shtator-Tetor.

Mbjellja ishte planifikuar në 95 Ha, ishte realizuar në 88 Ha.

Organizimi dhe përcjellja e korrjeve: Korrik-Shtator. Korrja u krye në 88 Ha me një rendiment mesatar prej 2650 kg / Ha.

Nga buxheti komunal janë paguar **89,996€** për subvencione në prodhimtari blegtorale:

Lopë	1713x30	=	51390	
Dele	9724x3	=	29172	
Bletë	3222x2	=	6444	
Pula Vojse	7730x0,20	=	1564	
Thëllëza	600x0,30	=	180	
Dhi	82x3	=	246	
Gjithsej				88996 €

Në aktivitetet gjatë regjistrimit të prodhuesve bujqësorë dhe fermave, të cilat drejtohen si ferma komerciale, u formua gjendja dhe numri i blegtorisë, si dhe sipërfaqja e prodhimit të arave dhe frutave. **Në vitin 2022 janë regjistruar edhe 26 fermerë të rinj.**

Vërejtje: fermerët që kanë prodhuar prodhim bujqësor nga fshati Plajnik në vitet e kaluara nuk kanë mundur të marrin pjesë në projektin e subvencionimit për shkak të marrëdhënieve të pazgjithura pronësore, por megjithatë kanë prodhuar.

Sektori i Inspeksionit:

1. Rritja e kontrolleve mbi çmimin e derivateve të naftës për shkak të vendimeve të qeverisë në baza javore dhe mujore.
2. Janë rritur kontrollet e tregut dhe sanitare nëpër ndërmarrje rreth sigurisë dhe mbrojtjen shëndetësore të qytetarëve;
3. Lufta kundër uzurpimit të pronës shoqërore.

Gjendja vjetore e inspektimit për vitin 2022 është si vijon:

Nr.rr.	Emri dhe mbiemri i Inspektorit Dhe emri i inspeksionit	Numri i kontrollimeve	Nr.i procesve me Vendim	Nr.i procesve pa Vendim	Numri i kërkesave për procedurë kundërvajtëse	Numri i licencave të	Numri i ankesave të	Nr. i thirrjeve të paleve	Numri i inspektimeve me të tjerët / policia	Vërejtje
1	Enis Sylejmani Inspektor i tregut	<u>189</u>	<u>115</u> Vendime për izolim	<u>/</u>	<u>10</u> Dënime administrative	<u>5</u>	<u>/</u>	<u>/</u>	Kontrolli në bashkëpunim me policinë dhe Inspeksionin e Tregut të Republikës.	-Kontrolli ka vazhduar në bashkëpunim me AVUK dhe Policinë e Kosovës.
3	Armend Piraj Inspektor Komunal	<u>237</u>	<u>9</u>	<u>/</u>	<u>2</u>	<u>5</u>	<u>7</u>	<u>/</u>	Kontrolli në bashkëpunim me policinë dhe inspeksionin rajonal.	-Kontrolli ka vazhduar në bashkëpunim me AVUK dhe Policinë e Kosovës.
4	Vetim Hasani Inspektor i ndërtimit	<u>34</u>	<u>9</u>	<u>25</u>	<u>/</u>	<u>/</u>	<u>/</u>	<u>/</u>	<u>/</u>	<u>/</u>

Sekcija Šumarsva:

- Raspisana je bila licitacija preko kancelarije za nabavke o prodaju tehničke mase u planiranim regionima opštine, tender je dobila firma “ **BREDHIKU** ” SH.P.K. iz Prizrena , sa kojom su i potpisani ugovori.
- Raspisana je bila licitacija preko kancelarije javne nabavke za prodaju tehničke mase polomljenih drvnih asortimana usled pojave nastanka klimatskih faktora koje je pogodilo Opštinu Dragaš, i to po planu AŠK. Tender je dobila firma “ **BREDHIKU** ” SH.P.K. iz Prizrena , sa kojom su i potpisani ugovori.

- Izvrshena je slobodna prodaja ogrevne drvne mase građanima Opštine.
 - Direktorijati je vršio aktivnosti van granica svoje kompetencije u nacioanalnom parku "Šar" na osnovu memoranduma Opštine Dragaš i Ministarstva Ambijenta zbog nedovoljnih službenika Direktorijata parka za našu Opštinu.
- Npomena:** - Izvrsheno je pošumljavanje 11 hektara za 2022 sa preko 32.500 sadnica.

Sektor i Pylltarisë:

- Èshtë shpallur oferta përmes zyrës së prokurimit për shitjen e masës teknike në rajonet e planifikuara të komunës, kompania " BREDHIKU " SH.P.K. nga Prizreni, me të cilën u nënshkrua kontrata.
- Përmes zyrës së prokurimit publik është shpallur ankandi për shitjen e masës teknike të asortimenteve të drurit të thyer për shkak të paraqitjes së faktorëve klimatikë që kanë prekur Komunën e Dragashit, sipas planit të ASK-së. Tenderin e ka fituar shoqëria "BREDHIKU" SH.P.K. nga Prizreni, me të cilin janë lidhur kontrata.
- Ka përfunduar shitja e lirë e masës së drurit për qytetarët e komunës.
- Drejtoria ka realizuar aktivitete përtej kufijve të kompetencës së saj në parkun nacional "Sharri" bazuar në Memorandumin e Komunës së Dragashit dhe Ministrinë e Mjedisit për shkak të zyrtarëve të pamjaftueshëm të parkut për komunën tonë.

Vërejtje: Èshtë kryer pyllëzimi i 11 hektarëve për vitin 2022.

TE ARDHURAT DHE SHPËRNDARJA MJETEVE NË BUXHET PËR PERIU DHËN JANAR-NËNTOR 2022

Nr.Rr	Përshkrimi i të ardhurave	Të ardhurat nga
I	Të hyrat e administratës komunale të pylltarisë	01.01.-30.11/22 në €
1	Shitja e lëndës drusore teknike Tender - Pagesa sipas Marrëveshjes	3625.06
2	Taksa për shitjen e masës drurore	26719.79
3	Taksat për shitjen e drurit teknik sipas normës (me pakicë)	1124.80
4	Kompensimi i dëmeve në pyjore	323.03
5	Taksa për degët, degët e lajthisë, plehrat etj.	754.00
6	Taksa për shitjen e lëndës drusore të konfiskuar	0.00
7	Taksat për shërbimet nga pyjet private	565.96
8	Tarifat e pastrimit të pyjeve (pisha të thata, të djegura, etj.)	998.40
11	Taksat për bimët aromatike, frutat e pyllit, kullotat	0.00
12	Të hyra të tjera (KEDS dhe shkurtime sanitare)	335.55
II	Gjithsej	34 446,62



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
REPUBLIC OF KOSOVO



Kuvendi Komunal Dragash – Skupština Opštine Dragaš – Municipality of Dragash
Drejtoreti për Bujqësi, Inspeksion, Turizëm, Pylltari dhe Zhvillim Rural
Direktorijati za Poljoprivredu, Inspekciju, Turizm, Šumarstvo i Ruralni Razvoj
Directorate for Agriculture, Inspections, Tourism, Forestry and Rural Development

DATA/DATUM:	18/01/2022
REFERENCE-E:	09/Br.
PËR/ZA/TO:	Kancelariji Predsednika Opštine Dragaš
CC:	
PERMES/PREKO/THROUGH:	Skupšinska služba prevođenja
NGA/OD/FROM:	Drejtoreti për Bujqësi, Inspeksion, Turizëm, Pylltari dhe Zhvillim Rural Drejtor: Erdjan Limançe
TEMA/SUBJEKT/SUBJECT:	PLANI I PUNËS PËR VITIN 2023.

TË NDERUAR!

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Statutit të Komunës së Dragashit, drejtori i Drejtoratit për Inspeksion, Turizëm, Pylltari dhe Zhvillim Rural, dërgon këtë **Plan të Punës të Drejtoratit, për vitin 2023.**

Plani vjetor i Drejtoratit...përfshinë periudhën prej 03.01- 30.12.2023. Kuptimi i koncepteve për këtë Plan janë mjaft fleksibile me mundësi të përshtatjes së ndryshimeve të shkaktuara, harmonizimit kohor me lëvizje të vërteta dhe zhvillimin e Komunës së Dragashit.

Si qëllime kryesore të këtij Plani janë: përmirësimi i efikasitetit dhe funksionalitetit të Drejtoratit, kontaktet direkte dhe të përhershme me drejtoratet tjerë, ministritë përkatëse, partitë, institucionet ndërkombëtare dhe sigurimi i diciplinës në punë në atë nivel i cili mundëson kushte për punë ligjore të Drejtoratit.

SEKSIONI PËR BUJQËSI, TURIZËM DHE ZHVILLIM RURAL:

Siç dihet, dhe duke pasur parasysh se politika shtetërore agrare definohet në MBPZHR dhe nuk ekzistonë kompetencë direkte shtetërore e Komunës lidhur me këtë, pos në pjesët lidhur me udhëheqjen e tokës ndërtimore. Por, ekziston nevoja evidente dhe dëshira që të sigurohet zhvillimi i bujqësisë në komunën tonë, për këtë Komuna dhe vetë Seksioni për Bujqësi të cilat janë më afër bujqëve ka rol të rëndësishëm në zhvillimin e bujqësisë të orientuar në katër drejtime:

- **Krijimi i kushteve të volitshme për investime në bujqësi dhe përpunim,**
- **Përgatitjet për shfrytëzimin sa më të mirë të mjeteve të Miniastrisë, fondeve të BE-së apo donatorëve,**
- **Përmirësimi i kapaciteteve lokal të qeverisjes për t'u përgjigjur kompetencave që ka Komuna në mënyrë sa më cilësore,**
- **Sigurimi i përkrahjes direkte të bujqëve në kuadër të mundësive vetanake.**
- **Organizimi i panairit të produkteve bujqësore.**

Bashkëpunimi me MBPZHR dhe Zyrën Rajonale: Për çështjet e zhvillimit të projekteve, seminareve për çështjen e projekteve, seminarave për përkrahje, raportim, informata, lajmërimi, ndihma fermerëve për projektet e programeve të subvencioneve të ndryshme, granteve dhe premive.

Subvencionet dhe grantet:

- Pjesëmarrja aktive e shërbimit për projektet e subvencioneve të mjeteve të grantit për prodhimtari bujqësore, njoftimi me kriteret për aplikim të cilat i rekomandon MBPZHR.
- Përpunimi dhe kontrollimi i mbjelljeve dhe korrjeve:
 - a. Mbjelljet dhe korrjet pranëverore, Prill-Maj,
 - b. Mbjelljet dhe korrjet vjeshtore, Shtator-Tetor,
 - c. Raportet t'i dërgohen MBPZHR.

Bashkëpunimi me donatorët: Me investitor vendor dhe të jashtëm do të punohet për zhvillimin e Bujqësisë në Parkun Nacional "Sharri" lidhur me realizimin e projekteve të Komunës dhe drejtoratit në kufi të parkut për ndihëma në bujqësi për hartimin e kontratave për shfrytëzimin e kullotave të larta për kullotje sezonale në kuadër të Parkut Nacional "Sharri", si dhe kërkesa nga udhëheqësia e Parkut nacional për hartimin e kontratave me fermerë për tokën e punëshme bujqësore për nevojat e mbjelljeve dhe sigurimi i ushqimit për kafshë për fermat ekzistuese, si dhe për qëllime komerciale.

Bashkëpunimi me kooperativat, fermerët dhe gupe fermerësh: Çdo muaj këshillime profesionale, trajnime për promovim më të mirë të prodhimeve me theks të vaçantë në prodhimtari blegëtorale. Në kërkesa, probleme dhe nevoja të fermerëve të gjenden zgjidhje të pranueshme. Vizitat e qumshitoreve dhe pikave grumbulluese në komunën tonë.

Bashkëpunimi me HELP-in, UNDP-in, CARITAS-in dhe IADK-në: Këto organizata ndërkombëtare e kanë përfunduar programin për Komunën e Dragashit dhe Komuna do të shqyrton mundësitë e vazhdimit të bashkëpunimit me HELP-in, UNDP-in, Caritas-in dhe IADK-në përmes aktiviteteteve në zhvillimin e bujqësisë dhe cicëronit turistik për zhvillim të komunës së Dragashit.

Organizimi i panairove dhe ekspozitave bujqësore:

- Në ekspozitën dhe panairin e Prillit, ekspozita e kafshëve: lopë mjelëse, mëshqerra, demave, deleve, dhive dhe kafshë tjera.
- Ekspozita dhe panairi i Tetorit të lopëve mjelëse, mëshqerrave, demave, deleve, dhive dhe kafshëve tjera. Prodhime bujqësore: qumësht, djathë, mish, mjalt, bimë mjekuese dhe fruta ekzotike,
- Mundësimi i pjesëmarrjes së fermerëve tonë në panairë tjera të Republikës Kosovës.

Mbajtje të takimeve me bletarë: Vizita, këshillime për mundësinë e organizimit të seminareve dhe trajnimeve për zhvillimin e bletarisë.

Bashkëpunimi me LGR Bio – Šari: Hartimi dhe implementimi i projektit për zhvillim rural.

Bashkëpunimi me organizatat e jashtme qeveritare: HELP, CARITAS, IADK, UNDP: të zhvillohen lidhjet e mira, të hartohen projekte të reja dhe të implementohen, dhe të ripërtrihen marrëdhëniet me ato organizata ku janë shkëputur lidhjet.

Të hartohen projekte ideore: Për donatorët potencial, me pjesëmarrjen e Komunës, për fillim të ndërtohet hapësira ekspozuese në lokalitete në të cilët do të ekspozohen prodhimet autokton dhe manifestimet karakteristike me tipare gjeografike dhe etno historike.

Vizita ambasadave të huaja: Përfaqësimi i komunës sonë, reklamimi i bjeshkëve, prodhimeve tona bujqësore, të kërkohen ambasada që të na organizojnë dhe gjejnë komuna për vëllazërimi. Pra, komuna të ngjajshme si e jona për zhvillim të blegëtorisë, bujqësisë dhe turizmit, kërkimi i investimit të shteteve dhe organizatave të tyre.

Azhurimi i web-faqes së Komunës: Linku i Drejtoratit në web-faqen të hartohet si faqe për botën Globale. Të vendosen të gjitha shënimet për të gjitha resurset me fotografi, si dhe ngjarjet në Drejtorat, si dhe të shpallen të gjitha lajmërimet, konkurset dhe kërkesat.

INSPEKSIONI

Detyrë themelore për Inspeksionin është të kontrollohen të gjitha veprimtaritë, në mënyrë që qytetarëve t'u mundësohet shërbime të shëndosha dhe efikase, mbrojtjen e konsumatorëve dhe t'u dilet në ndihmë konsumatorëve, si dhe bashkëpunimi me drejtoratet tjera në aspektin e asistencës. Vazhdimi i monitorimit të vendimeve të Qeverisë për situatën në terren.

Inspeksioni i tregut:

- **Kërkesat:** shqyrtimi i kërkesave dhe nevojave të qytetarëve.
- **Regjistrimi dhe licencimi:** identifikimi i subjekteve të paregjistruara afariste në Komunën e Dragashit,

- **Njoftimi i subjekteve afariste:** për iniciativat e reja, sugjerimet dhe propozimet në sferën e inspektionit të tregut, në zhvillimin e hovshëm të teknologjisë, ekonomisë dhe biznesit në tërësi. Do të ketë informacione për ligjet e reja,
- **Mbikqyrje,të zbatohet Ligji për Inspeksionin e Tregut sipas nenit 6:** për Tregtin e Brendshme, Ligjin për Konsumatorët, Ligjin për Njësitë Matëse,si dhe dispozita përkatëse të parapara me ligjin të cilat i referohen Inspeksionit të Tregut,
- **Vizita dhe kontrolli i prodhimeve:** subjekteve afariste në terrenin e Komunës së Dragashit,
- **Lufta kundër ekonomisë joligjore:**
- **Ofrimi ndihmës profesionale:** subjekteve afariste për eliminimin e parregullësive me rastin e ushtrimit të veprimtarive afariste,

Inspeksioni i Çështjeve Komunale:

- Zbatimi i ligjit dhe rregulloreve:** për rend publikë, në të mirë të popullit,
- Mbrojtja e ambientit:** nga ndotja përmes veprimeve të ndryshme nga ana e popullatës dhe ndërmarrjeve,
- Kontrolli dhe menaxhimi:** hapësirave publike,ujësjellësëve dhe kanalizimeve,
- Kontrolli:** subjekteve afariste në terren me inspektorët tjerë,
- Kërkesat:** shqyrtimi i kërkesave dhe nevojave të qytetarëve.

Inspeksioni i Ndërtimtarisë:

- Zbatimi i Ligjit dhe rregulloreve:** ndërtimi në tërë teritorin e komunës së Dragashit.
- Kontrolli:** i objekteve për marrjen e lejeve për ndërtim,grupeve të mjeshhtëreëve se a kanë ndërmarrje të regjistruara,
- Komisioni:** pranë Komisionit Komunal për vlerësimin e tenderëve,
- Të mbrohet:** pasuria shoqërore dhe pengimi i uzurpimit të rrugëve publike dhe ndërtimeve që bëhen në to,
- Kërkesat:** shqyrtimi i kërkesave dhe nevojave të qytetarëve.

PYLLTARIA

Plani i menaxhimit të pyjeve, për vitin 2023 është, si vijon:

- Realizimi i Planit të APK-së për vitin 2023,
- Rregullimi parakomercial dhe planifikim të prerjes së pyjeve,
- Bërja e ankandit me zyrën e prokurimit,
- Ekzekutimi i shitjes së masës drurore, për vitin 2023,
- Mbrojtja e pyjeve dhe drurëve, dhe kryerja e kontrolleve të planifkuara,
- Rauajtja dhe mbrojtja e pyjeve nga zjarret dhe çështjeve tjera të padëshiruara,



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVO-
REPUBLIC OF KOSOVO

KUVENDI KOMUNAL DRAGASH – SKUPŠTINA OPŠTINE DRAGAŠ-
MUNICIPALITY OF DRAGASH

**DREJTORIA E FINANCAVE, EKONOMISË DHE
ZHVILLIMIT**

RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2022

DHE

PLANI I PUNËS PËR VITIN 2023



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO

Kuvendi i Komunës së Dragashit - Skupstina Opstine Dragas

Drejtorati për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim – Direktorijat Ekonomije, Finansije i Razvoja



Datë/a-Datum:	10.01.2023
Referencë	
Për-Za:	Kryetarin Bexhet Xheladini dhe Kuvendin e Komunës së Dragashit
Përgatitur nga:	Drejtorati për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim
Përmes-Preko :	Email dhe Arkivit
Nga-Od:	Qamil Kolloni, drejtor i Drejtoratit për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim
Tema:	Raporti i punës për vitin 2022 i Drejtoratit për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim

Drejtorati për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim është i organizuar në këto njësi punuese:

Nr.	Njësitë Punuese (Sektorët)	Veprimtaria
1	Buxhet	Përgatitja e buxhetit sipas Qarkores Buxhetore të MEF
2	Financa	Raportet financiare - transferet
3	Zyra e Tatimit në Pronë	Vlerësimi, faturimi, inkasimi i tatimit në pronë
4	Zyra për Regjistrimin e Bizneseve	Regjistrimi i Bizneseve
5	Njësia e Thesarit- regjistrimit të pasurisë komunale	

Njësia Punuese për Buxhet

Drejtorati për Ekonomi Financa dhe Zhvillim, bazuar në dispozitat e nenit 60 dhe 61 të Ligjit mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, si dhe Qarkoreve Buxhetore 2023/1,2, ka marrë pjesë në përgatitjen e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve dhe Projekt-buxhetin për vitin 2023-2025, për periudhën në fjalë, duke i respektuar afatet dhe procedurat e aprovimit të buxhetit.

Drejtorati për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim ka përgatitur Planin e Veprimit për rekomandimet e auditorit për Pasqyrat Financiare 2021 dhe raportet e progresit për zbatimin e rekomandimeve për raportin e auditimit për vitin 2021.

Drejtorati për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim ka përgatitur Rregulloren për Tatimin në Pronë dhe ka raportuar në Asamblenë Komunale për raportet e realizimit të buxhetit.

Drejtorati për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim ka marrë pjesë nëpër dëgjime publike të organizuara në Asamblenë Komunale dhe nëpër fshatra për propozim-buxhetin e vitit 2023.

Njësia Punuese e Financave

Ka përgatitur raportet mujore financiare, si dhe raportet tremujore financiare, për raportim në Asamblenë Komunale.

Në vazhdimësi kryen të gjitha pagesat dhe transaksionet për investime kapitale, mallra dhe shërbime, si dhe përcakton procedurat për ekzekutimin e pagesave.

Njësia e Tatimit në Pronë

Detyra kryesore e zyrës është që çdo vit të llogarisë dhe të faturojë pronarët dhe përdoruesit e pasurive të paluajtshme, shumën e taksave që duhet të paguajnë për një vit të caktuar, si dhe të marrë të gjitha masat e nevojshme për të mbledhur sa më shumë tatimin e llogaritur dhe të zbritur të pronës. Gjithashtu, të regjistrojë të gjitha objektet dhe pronat e reja, si dhe të verifikojë të paktën 1/5 e objekteve ekzistuese.

Për vitin 2022 kemi arritur këto rezultate:

- Janë printuar dhe shpërndarë përafërsisht 10.000 fatura dhe vërtetime për rreth 6.000 tatimpagues.
- Janë mbledhur një shumë totale e tatimit në pronë prej 293.345.68€, prej të cilave 246.757.68€ janë tatim për objekte dhe 46,588,00€ për parcela. Kjo është 7% më shumë se në vitin 2021.
- Janë pranuar gjithsej 168 ankesa nga tatimpaguesit, nga të cilat 157 janë miratuar dhe zgjidhur në favor të tatimpaguesve, 48 ankesa për objekte dhe 110 për toka (parcela).
- Janë verifikuar 1685 objekte ekzistuese në vendbanime të ndryshme,
- Janë regjistruar dhe futur në programin Protax 331 objekte ose njësi objektesh të reja.
- Janë evidentuar dhe arkivuar 488 kontrata për transaksionet e pasurive të paluajtshme.

Palëve të ndryshme për qëllime të realizimit të të drejtave të tyre qytetare u janë lëshuar 4.188 vërtetime të ndryshme, siç janë: aplikimi për pensione, aplikimi për social, vërtetimi i kontratave të ndryshme, fitimi dhe humbja e shtetësisë së Kosovës, subvencionet etj. si dhe vërtetime të ndryshme për banka dhe institucione të tjera mbi 6000.

Njësia e Thesarit

Zyrtari i parave të imëta ka punuar në përgatitjen dhe tërheqjen e parave nga banka, në vlerë 2000 euro, si dhe ka bërë pagesa me para të gatshme. Përveç kësaj, ka pranuar nga zyrtarët e administratës paratë e inkasuara në vlerë 51.560.00 euro, dhe të njëjtat i ka deponuar në xhirlogarinë bankare të Komunës. Regjistrimin e pasurive me vlerë mbi 1000 euro dhe nën 1000 euro në SIMFK.

Njësia - zyrtari përgjegjës në Qendrën Komunale për Regjistrimin e Biznesit

Mbajtja e kontratave të shfrytëzuesve të përkohshëm të objekteve komunale me karakter të përkohshëm dhe mbajtja e kontratave të pronës komunale me shfrytëzim afatshkurtë dhe afatgjatë, në bazë të ankandeve të organizuara nga Komisioni Komunal për Dhënie në Shfrytëzim të Pronës Komunale, i themeluar nga Asambleja Komunale.

Nr	Përshkrimi	Nr	Vërejtje
1	Vërejtje të fundit për pagesë për shfrytëzues të përkohshëm	120	121
2	Regjistrim i bizneseve të reja	52	
3	Shuarje të bizneseve	15	
4	Kërkesë për informata	28	
5	Kërkesë për shtim të aktivitetit	07	
6	Kërkesë për ndryshim të emrit	01	
7	Kërkesë për ndryshim të adresës	12	
8	Kërkesë për ndryshim të njësisë	03	

Për të realizuar objektivat e performancës për përfitim të Grantit, drejtorja ka ndërmarrë masat preventive për të vënë në zbatim rekomandimet e auditorit të jashtëm dhe atij të brendshëm. Për këtë qëllim kemi ndërmarrë këto veprime:

1. Janë rregulluar dhe ndarë përgjegjësitë e depoistit dhe zyrtarit të logjistikës dhe kemi rregulluar pranim-dorëzimin e materialit dhe shpërndarjes në sektorët sipas kërkesës,
2. Është bërë regjistrimi i pasurisë komunale mbi vlerën 1000 dhe nën vlerën 1000 euro në kopje fizike dhe është protokoluara për herë të parë në një regjistër të përbashkët me sektorin e Arsimit dhe atë të Shëndetësisë,
3. Është bërë inventarizimi dhe regjistrimi i Muzeut Etnografik, i cili ka qenë i paregjistruar fare dhe për të cilin ende nuk është bërë pranim-dorëzimi i atij muzeu,
4. Janë procesuar dhe janë shqyrtuar 400 lëndë të ndryshme nga 630 sosh, të cilat kanë qenë pa u procesuar deri në vitin 2021. Pjesa tjetër e lëndëve kanë qenë irelevante,
5. Janë verifikuar 1772 biznese.

Bazuar në regjistrin e bizneseve në Komunën e Dragashit, në periudhën nga viti 2002 deri në tetor 2022 janë regjistruar 1772 biznese të cilat nga data 20 tetor 2022 kanë statusin e paraqitur në tabelë:

Nr.	Statusi	Numri i bizneseve
1	Bizneset aktive	790
2	Bizneset pasive	514
3	Bizneset e çregjistruara	428
4	Status i panjohur	40
	Total	1772

Në periudhën mes 2002-2020 janë paguar 332 539,43€. Disa nga bizneset kanë shlyer të gjithë borxhin dhe disa kanë bërë pagesën e pjesshme, kështu që sot, kur është përpiluar ky raport, totali i borxhit në emër të taksës komunale për bizneset për periudhën 2002 – 2013 arrin shumën 596 636,11 €.

Sipas regjistrin të Agjencisë Tatimore të Kosovës, statusi i bizneseve që kanë borxhe është paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Statusi	Numri i bizneseve	Borxh
Aktiv	364	255 842.77 €
Pasiv	297	221 265.50 €
I shuar	130	94 484.84 €
I panjohur	25	25 043.00 €
Total	816	596 636.11 €

Raport për taksat komunale mbi qiranë për shfrytëzimin e objekteve komunale dhe tokës që përfundon në vitin 2022:

Përshkrimi	Nr.
Njoftime të fundit për shlyerje të borxhit	109
Njoftimi nuk është dorëzuar për shkak të vdekjes së palëve ose adresave të panjohura	14
Palëve u janë dhënë përkujtesa përfundimtare	95
Lëndë të dërguara në përmbarim	67
Persona të vdekur	8

Persona që kanë shlyer borxhin pas shtyrjes së afatit të pagesës pas datës 30 shtator 2022	20
Persona që nuk kanë dalë fare për të shlyer borxhin	39
Persona që janë në abonim në shumën prej 203,25 €	2

Qiraja për lokalet e debitorit 23, aktive 14

Total ngarkesa	205.553,50 €
Total Pagesa	139.480,37 €
Falje e Borxhit	7.786,81 €
Total Borxhi	58.286,31 €

Qiraja për tokat aktive - 107 Lokacione

Total ngarkesa	387.459,19 €
Total Pagesa	188.881,67 €
Falje Borxhit	34.609,12 €
Total Borxhi	167.198,65 €

Qamil Kolloni

Drejtor i Drejtoriatit për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim - Komuna Dragash



Mob: 044/201-072

E-mail: Qamil.Kolloni@rks-gov.net

Web: kk.rks-gov.net/dragash/

Adresa: Sheshi Dëshmorëve 22000 Dragash



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
Kuvendi i Komunës së Dragashit - Skupstina Opstine
Dragas

Drejtorati për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim – Direktorijat Ekonomije, Finansije i Razvoja

Datë/a-Datum	10.01.2023
Referenc-ë	
Për-Za :	Kryetarin Bexhet Xheladini dhe kuvendin e komunës së Dragashit
Përgaditur nga	Drejtor i Ekonomis Financave dhe Zhvillim
Përmes-Preko :	Email dhe Arkivit
Nga-Od :	Qamil Kolloni Drejtor i Ekonomis Financave dhe Zhvillim
Tema :	Plani i punës i drejtorisë për Ekonomi Financa dhe Zhvillim - 2023

Plani i punës i drejtorisë për Ekonomi Financa dhe Zhvillim - 2023

Drejtorati për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim i komunës së Dragashit, duke pas për bazë detyrat, obligimet dhe përgjegjësitë që dalin nga dispozitat ligjore dhe statuti i komunës së Dragashit, punën dhe veprimtarinë e vetë në vitin 2023 do ta përqendrojë në:

1. Menaxhimin e buxhetit ne baze të Ligjit mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësiive, Ligjit mbi Financat e Pushtetit Lokal, Udhëzimeve Administrative dhe rregullave financiare të lëshuara nga MF dhe Komuna.

2. Monitorimin e regjistrimeve efikase dhe të sakta të të gjitha të hyrave, si dhe lehtësimin e rrjedhës së lirë të shpenzimeve në një mënyrë që është në konsistencë me rregullat e duhura të menaxhimit financiar dhe të bëjë regjistrimin e saktë të tyre.
3. Të përgatiten raporte financiare sipas kërkesave të Ligjit mbi Menaxhimin e Financave Publike në pajtim me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit të sektorit publik i bazuar në paratë e gatshme dhe me statistikat qeveritare.
4. Të plotësohen nevojat për informata nga ana e palëve kryesore të interesuara, duke përfshirë Kuvendin, Qeverinë, Donatorët, komunitetin dhe publikun.
5. Të siguroj që të bëhet barazimi sipas kërkesave të LMFP në mes të SIMFK-së dhe Organizatës buxhetore.
6. Rritja e efikasitetit në punë në arkëtimin e të hyrave vetanake, tatimit në pronë, taksave dhe ngarkesave të ndryshme komunale dhe mundësia e gjetjes së burimeve tjera financiare, përmes donacioneve apo formave tjera,
7. Rritja e transparencës në nivelin më të lartë, para qytetarëve në grumbullimin, shfrytëzimin dhe shpenzimin e parasë publike.
8. Propozimi i rregulloreve financiare në asamblenë komunale.
9. Përgatitjen dhe hartimin e strategjisë për zhvillim ekonomik lokal.

PLANI I PUNËS PËR PERIUDHËN JANAR - DHJETOR 2023

Nr	Përshkrimi i detyrave të planifikuara	Afati
1	Punët përgatitore për fillimin e vitit buxhetor sipas Udhëzimit Administrativ - punimi dhe dorëzimi i planit të rrjedhjes së parasë së gatshme në Ministrinë e Financave-Departamenti i Thesarit-ZKF	12 janar 2023
2	Barazimi i të hyrave dhe shpenzimeve me të dhënat në SIMFK Sipas afateve të caktuara nga ana e MEF- it Departamentit të Thesarit. -ZKF	26 janar 2023
3	Përgatitja dhe dorëzimi i Pasqyrave financiare për vitin e përfunduar më janar-dhjetor 2022 të punuara sipas rregulloreve financiare- ZKF	29.01.2023
4	Regjistrimi dhe raportimi mbi të hyrat vetanake të komunës	Detyrë e përhershme
5	Regjistrimi dhe ekzekutimi i urdhërpagesave në SIMFK	Detyrë e përhershme
6	Regjistrimi dhe tërheqja e avanseve për pagesa me para të gatshme. Pranimi i parave nga inkasimi dhe dorëzimi në llogarinë bankare të komunës dhe përgatitja e raporteve.	Detyrë e përhershme

7	Regjistrimi i pasurisë mbi 1000 euro ne SIMFK dhe regjistrimi ne e- pasuri nen 1000 euro.	Detyre e perhershme
8	Regjistrimi i bizneseve, konsulta të ndryshme rreth bizneseve, mbajtja e kontratave pasi qe ato te nënshkruhen për ngarkim te qirasë, pagesa e qirave ne baza mujore.	Detyre e perhershme
9	Përgatitja e nismës për inicimin e shpenzimeve për investime kapitale.	Shkurt 2023
10	Shtypja e faturave, specifikat dhe vlerësimet e tokave për tatimpaguesit te cilët jetojnë në Komunën e Dragashit. Informimi i tatimpaguesve rreth aplikimit te tatimit ne tokë.	Shkurt 2023
11	Shpërndarja e faturave të tatimit në pronë Lëshuara e aktvendimeve mbi ngarkesën e qirave vjetore për shfrytëzimin e tokës ndërtimore, Barazimi i te hyrave vetanake dhe shpenzimeve me te dhënat nga SIMFK.	Shkurt-Mars Mars Fundi i Marsit
12	Pranimi i ankesave dhe vrejtimeve nga qytetaret per faturat e tatimit ne prone.	Mars
13	Bartja e te hyrave vetanake te pashpenzuara.	Mars-Prill 2023
14	Raporti periodik mbi shpenzimin e mjeteve buxhetore për periudhën janar –mars 2023.	Fundi i prillit 2023

15	Përgatitja dhe hartimi i strategjisë për zhvillim ekonomik lokal.	Mars-Dhjetor
16	Raporti mbi numrin e bizneseve të regjistruara pranë qendrës për regjistrimin e bizneseve në Dragash.	15 prill 2023
17	Seleksionohen, verifikohen dhe printohen faturat e borxhlinjeve më të mëdhenj të tatimit në pronë përsëri tu shpërndahen faturat dhe nëse nuk paguhen borxhet të ndërmerren masa të parapara me ligj për pagese të detyruar.	Maj
18	Regjistrimi i të gjitha objekteve të reja të ndërtuara dhe verifikimi i objekteve tjera ekzistuese lëshuarja e vërtetimeve dhe dokumenteve (vërtetimi për regjistrim të automjetit, për ndihma sociale, për viza etj).	Detyrë e përhershme
19	Bartja e shitblerjeve të kontratave dhe bashkëpunimi me MEF, Departamenti i tatimit në pronë.	Detyrë e përhershme
20	Raporti mbi inkasimin e mjeteve nga shfrytëzimi i tokës dhe objekteve në pronësi të komunës me karakter të përkohshëm.	Detyrë e përhershme
21	Pagesa e tatimit, lëshuarja e certifikatave të ndryshme për pagesën e tatimit dhe regjistrimi i objekteve të reja.	Detyrë e përhershme
22	Paraditja dhe procedimi i urdhër zotimeve për pagesë.	Detyrë e përhershme
23	Përgatitja e raportit të shpenzimeve dhe të hyrave për periudhën janar-qershor 2023.	Korrik 2023
24	Debat publik rreth projekt propozimit të Buxhetit për vitin 2023-2026.	Korrik 2023

25	Përgatitja dhe shqyrtimi i Rregullores për vendosjen e tatimit në Pronë për vitin 2023 (varësisht nga Qarkoret Buxhetore të cilat i lëshon Ministria e Financave).	Fundi i Tetorit
26	Debati i dytë lidhur me buxhetin 2023-2026 (varësisht nga Qarkoret Buxhetore të cilat i lëshon Ministria e Financave).	Gusht 2023
27	Shqyrtimi i Raportit mbi realizimin e buxhetit për periudhën janar-shtator 2023.	Tetor 2023
28	Punët përgatitore rreth përmbyllje së UZP sipas afateve të cilat i përcakton MEF-i -Departamenti i Thesarit.	Nentor 2023
29	Punët e përmbylljes së vitit buxhetor 2023.	Dhjetori 2023

Drejtorati për Ekonomi Financa dhe Zhvillim do të bashkëpunojë ngushte me institucionet qeveritare të Republikës së Kosovës. Varësisht nga plani dhe programi i Ministrive përkatëse, punëtorët e këtij drejtorati do të jenë pjesëmarrës të aktiviteteve në trajnime dhe ligjërata të cilat do të organizohen nga ministritë organizatat dhe asociacionet.

Qamil Kolloni

Drejtor i Drejtoriatit për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim - Komuna Dragash



Mob: 044/201-072

E-mail: Qamil.Kolloni@rks-gov.net

Web: kk.rks-gov.net/dragash/

Adresa: Sheshi Dëshmorëve 22000 Dragash



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVO-
REPUBLIC OF KOSOVO

KUVENDI KOMUNAL DRAGASH – SKUPŠTINA OPŠTINE DRAGAŠ-
MUNICIPALITY OF DRAGASH

**DREJTORIA E KULTURËS, RINISË DHE
SPORTIT**

**RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2022
DHE
PLANI I PUNËS PËR VITIN 2023**



Republika e Kosovës
Republika Kosova/ Republic of Kosovo
Komuna e Dragashit/ Opština Dragaš/ Dragash Municipality
Drejtoria për Kulturë, Rini e Sport



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
Komuna e Dragashit
Opština Dragaš

02 Nr. Br. 020/21-1131/23
11.01.2023
Dragash - Dragaš

RAPORTI I PUNËS PËR PERIUDHËN JANAR – DHJETOR 2022

Dhjetor 2022

Në kuadër të DKRS vepron sektori i Kulturës, Rinisë e Sportit dhe gjashtë biblioteka me gjithsejtë 10 punëtor. Bazuar në planin e punës për vitin 2022 të paraqitur dhe të miratuar nga Asambleja Komunale, Drejtoria për Kulturë, Rini e Sport gjatë kësaj periudhe raportuese ka bërë përpjekje maksimale në realizimin e të gjitha detyrave dhe objektivave me qëllim që në tërësi të realizoi planin dinamik të aktiviteteve për këtë vit kalendarik. Marrë në përgjithësi prioritet për drejtorinë ka qenë shënimi i festave kombëtare po gjithashtu rëndësi i është kushtuar edhe aktiviteteve të tjera kulturore, rinore e sportive.

Më poshtë po i paraqesim aktivitetet e realizuara se bashku me angazhimet e përgjithshme.

Tabela e aktiviteteve të organizuara në vitin 2022

<i>Aktivitetet e organizuara dhe të mbështetura nga DKRS</i>	<i>Përshkrimi i aktivitetit</i>	<i>Muaji</i>
<i>17 Shkurti - Dita e Pavarësisë</i>	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Akademi Solemne, vendosja e kurorave tek shtatorja e Komandantit Legjendar Adem Jashari, varrezat e Dëshmorëve në Dragash e në fshatin Buçe. ▪ Turnir i futbollit me nxënësit e të gjithë shkollave fillore ▪ Turnir i futbollit me mësuesit e të gjithë shkollave fillore ▪ Turnir i volejbollit me vajzat e shkollës së mesme “Ruzhdi Berisha” 	<i>Shkurt</i>
<i>Epojeja e UÇK-së</i>	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Akademi Solemne, vendosja e kurorave tek shtatorja e Komandantit Legjendar Adem Jashari, varrezat e Dëshmorëve në Dragash e në fshatin Buçe. ▪ Turnir i futbollit me të gjitha institucionet ▪ Turnir i futbollit me nxënësit e shkollës së mesme “Ruzhdi Berisha” 	<i>Mars</i>
<i>5 Maji - Dita e Dëshmorëve të Atdheut</i>	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Akademi Solemne, vendosja e kurorave tek shtatorja e Komandantit Legjendar Adem Jashari, varrezat e Dëshmorëve në Dragash e në fshatin Buçe ▪ Realizuar në bashkëpunim me OVL të UÇK-së – Dega në Dragash 	<i>Maj</i>

<p><i>Takim me të rinjtë në kuadër të projektit "Erasmus +"</i></p>	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Projekt i mbështetur nga Komisioni Evropian në kuadër të programit " Erasmus +" dhe është implementuar nga organizata "Gender Integration Association" nga Shqipëria. Pjesëmarrësit që vizituan komunën tonë ishin nga shtete të ndryshme si Kosova, Shqipëria, Rumania, Gjermania, Greqia, Serbia, Polonia, Bosnja. Drejtoresha e DKRS, Liridona Misinaj dhe Drejtori i DKA, Selim Kryeziu i njoftuan pjesëmarrësit për punën e institucioneve komunale në sektorin e rinisë dhe vizionin për një të ardhme më të mirë të të rinjve tanë. 	<p><i>Qershor</i></p>
<p><i>Dita e Çlirimit të Komunës</i></p>	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Vendosija e kurorave tek shtatorja e Komandantit Legjendar Adem Jashari, varrezat e Dëshmorëve në Dragash e në fshatin Buçe. ▪ Turnir i futbollit me shkolla ▪ Program artistik me SHKA "Bresana" dhe këngëtarë të mirënjohur. ▪ Gara tradicionale e vrapimit të kuajve realizuar në bashkëpunim me klubin e Kuajve "Opoja". 	<p><i>Qershor</i></p>
<p><i>Festivali Mbarëkombëtar Folkloriko -Burimor "Opoja Vallëzon"</i></p>	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Festivali ka zgjatur tre ditë dhe është realizuar në bashkëpunim me SHKA "Bresana". ▪ Ansamblet dhe Shoqëritë kulturo-artistike që përformuan ishin nga Kosova, Shqipëria, Mali i Zi dhe Maqedonia e Veriut. 	<p><i>Korrik</i></p>
<p><i>Takim me të rinjtë e komunës</i></p>	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Debat me temën: Kërkesat e të rinjve dhe sfidat që i preokupojnë ata. ▪ Pjesëmarrës në panel, Drejtoresha e DKRS, Liridona Misinaj dhe drejtori i DKA, Selim Kryeziu. 	<p><i>Korrik</i></p>
<p><i>Turniri "Afrojmë Diasporën përmes Futbollit"</i></p>	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Turnir i futbollit me pjesëmarrje të ekipeve të fshatrave i organizuar në stadiumin e futbollit në fshatin Zgatar. Realizuar në bashkëpunim me KF "Opoja" dhe banorët e fshatit Zgatar. 	<p><i>Gusht</i></p>
<p><i>"Ditët e Diasporës"</i></p>	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Aktivitete kulturore e rinore të organizuara në Liqenin e fshatit Brezne me pjesëmarrje të bashkatdhetarëve të të gjitha grupmoshave e i realizuar në bashkëpunim me OJQ "AVOKO". 	<p><i>Gusht</i></p>

<i>“Ditët e Diasporës”</i>	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Aktivitete kulturore e rinore të organizuara në fshatin Brod me pjesëmarrje të bashkatdhetarëve nga komuniteti joshumicë i realizuar në bashkëpunim me OJQ ” ZAENO ZA BROD” 	<i>Gusht</i>
<i>Shënimi i Ditës Ndërkombëtare të Rinisë</i>	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Debat me të rinj i organizuar nga OJQ”AVOKO” dhe Komuna e Dragashit me mbështetje të OSBE-së. Temë diskutimi ishte: Sfidat e të rinjve të komunës tonë. Pjesë e panelit ishin Drejtoresha e DKRS Liridona Misinaj dhe Drejtori i DKA Selim Kryeziu. 	<i>Gusht</i>
<i>Festivali Mbarëkombëtar i Folklorit ” Rapsha 2022” – Tuz i Malit të Zi</i>	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Në këtë festival ka marrë pjesë SHKA” Bresana” dhe me sukses ka prezantuar vlerat kulturore të komunës tonë në mesin e shumë ansambleve dhe shoqërive pjesëmarrëse nga të gjitha territoret ku jetojnë shqiptarët (Mali i Zi, Shqipëria, Kosova, Maqedonia e Veriut, Greqia, Italia, SHBA e Lugina e Preshevës) 	<i>Gusht</i>
<i>Projekti - Promovimi i Qytetarisë aktive dhe vullnetarizmit</i>	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Në kuadër të projektit Promovimi i Qytetarisë Aktive dhe Vullnetarizmit tek te rinjtë ne Dragash, janë mbajtur trajnime duke ju ka ofruar të rinjve njohuri dhe shkathtësi për orientim profesional, dhe shkathtësi intervistomi, shkrim i CV, letër motivuese, intervista pune, etj realizuar në bashkëpunim me OJQ”AVOKO” 	<i>Shtator</i>
<i>Hapja e shkollës digjitale TECH HOUSE</i>	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Shkolla digjitale TECH HOUSE është mbështetur nga Ambasada Amerikane në Kosovë me anë të së cilës ofrohen kurse falas në fushën e teknologjisë për të rinjtë e Komunës të Dragashit. Kjo do të jetë një hapësirë e përbashkët për të gjithë të rinjtë e Dragashit për zhvillim të kreativitetit dhe potencialit të tyre në fushën e teknologjisë, dizajnit, robotikës. Shtëpia e Teknologjisë do të jetë një hapësirë e përbashkët për të gjithë të rinjtë e Dragashit për të fituar njohuri dhe shkathtësi në fushën e teknologjisë. Përveç ofrimit të trajnimeve kjo hapësirë do tu shërbej të gjithë studentëve dhe të rinjve të Dragashit si hapësirë për të zhvilluar idetë e tyre. Projekti implementohet nga OJQ “AVOKO” 	<i>Tetor</i>

<i>Kurs dy mujorë i gjuhës Angleze</i>	<ul style="list-style-type: none"> • Realizuar në bashkëpunim me bibliotekën e qytetit të Prizrenit të mbështetur nga Ambasada Amerikane në Prishtinë. ▪ Pjesëmarrës të rinjtë deri në moshën 18 vjeçare 	<i>Tetor - Nëntor</i>
<i>28 Nëntori – Dita e Flamurit</i>	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Akademi Solemne, vendosja e kurorave tek shtatorja e Komandantit Legjendar Adem Jashari dhe në varrezat e Dëshmorëve në Dragash e në fshatin Buçe ▪ Turnir në futboll për meshkuj ▪ Turnir në voleyboll për femra ▪ Program artistik – SHKA”Bresana” 	<i>Nëntor</i>
<i>Festivali i valles dyshe ”Dyshja na bashkon” – Kurbin - Shqipëri</i>	<ul style="list-style-type: none"> ▪ SHKA” Bresana” dhe me sukses ka prezantuar vlerat kulturore të komunës tonë në këtë festival dhe është shpërblyer me Çmimin e Karrierës 	<i>Nëntor</i>
<i>Festivali kombëtar folklorik ”Komorani 2022”</i>	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Në këtë festival ka marrë pjesë SHKA” Bresana” dhe me sukses ka prezantuar vlerat kulturore të komunës tonë në mesin e shumë ansambleve dhe shoqërive pjesëmarrëse. SHKA”Bresana” është shpërblyer me çmimin special të festivalit “MIHAL CIKO” 	<i>Dhjetor</i>
<i>Festivali i valleve dyshe ”Dyshja na bashkon” – Ulqin- Mali i Zi</i>	<ul style="list-style-type: none"> ▪ SHKA” Bresana” dhe me sukses ka prezantuar vlerat kulturore të komunës tonë në këtë festival dhe është shpërblyer me vendin e III- të 	<i>Dhjetor</i>
<i>75 vjetori i AFA”Rugova”- Pejë</i>	<ul style="list-style-type: none"> ▪ SHKA”Bresana” me sukses ka prezantuar në këtë eveniment të organizuar për nder të 75 vjetorit të Ansambllit “Rugova” 	<i>Dhjetor</i>

Në mbështetje të Ligjit Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L222 dhe Ligjit Nr. 04/L-116 nenin 58, të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L040, nenit 5,7 dhe 8 të Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, Drejtoria për Kulturë, Rini e Sport, bazuar në Thirrjet Publike nga DKRS dhe Vendimet e Kryetarit të Komunës ka bërë subvencionimin e OJQ-ve, ku përfitues ishin:

<i>Nr.</i>	<i>Emri i OJQ</i>	<i>Emri i projektit</i>	<i>Vlera</i>
1.	<i>Klubi Futbollistik ”OPOJA”</i>	Përkrahja për sportistët kulmor dhe klubet sportive	<i>35.000€</i>
2.	<i>Shkolla e Futbollit ”Aroma Sport”</i>	Fuqizimi i sportit dhe ngritja e kapaciteteve të sportistët kulminant	<i>5.000€</i>

3.	<i>Shkolla e Futbollit "Dragash Sport"</i>	Fuqizimi i sportit dhe ngritja e kapaciteteve te sportistët kulminant	5.000€
4.	<i>Klubi i Kuajve "Bresana"</i>	Organizimi garave të kuajve dhe pjesëmarrja aktive e klubit të kuajve "Opoja" në organizime kombëtare e ndërkombëtare	10.000€
5.	<i>Klubi i Shahut "Sharri"</i>	Përkrahja për sportistët kulmor dhe klubet sportive	4.000€
6.	<i>SHKA "Bresana"</i>	Organizimi i festivalit Folkloriko - Burimor "Opoja Vallëzon"	12.000€
7.	<i>SHKA "Bresana"</i>	Vlerat kulturore dhe ruajtja e folklorit dhe manifestimet e Komunës	8.430€
8.	<i>OJQ "Demokratska Omladina Gora"</i>	Promovimi i turizmit të Komunës së Dragashit për Ditën e Goranëve	3.950€
9.	<i>OJQ "Qendra"</i>	Ta njohim trashëgiminë e Kosovës dhe të Komunës së Dragashit	2.000€
10.	<i>OJQ "AVOKO"</i>	Promovimi i qytetërimit dhe vullnetarizmi të të rinjtë e Dragashit	3.000€
11.	<i>OJQ "Fidani"</i>	Sofra Opojane e Ymer Prizrenit	3.300€
12.	<i>OJQ "AVOKO"</i>	"Ditët e Diasporës - Mërgatës" – Liqeni i Breznës	5.300€
13.	<i>OJQ "ZAENO ZA BROD"</i>	"Ditët e Diasporës - Mërgatës" – Brod	4.000€

Investimet kapitale në kuadër të DKRS

<i>Nr.</i>	<i>Investimet kapitale</i>
1.	<i>Ndërtimi i stadiumit të futbollit në fshatin Blaq – projekt dy vjeçar</i>
2.	<i>Ndërtimi i nxehjes qendrore në Shtëpinë e Kulturës në Dragash</i>

Investimet nga pozicioni mallra dhe shërbime

Nr.	Investimet nga mallra e shërbime	Libra
1.	<i>Furnizimi me libra për bibliotekat</i>	<i>1506 - DKRS</i>
2.	<i>Libra për bibliotekën e qytetit – Shkrimtari nga Shqipëria, Sakip Cami</i>	<i>80 - Donacion</i>
3.	<i>MKRS - Biblioteka Kombëtare</i>	<i>200 - Donacion</i>

RAPORTI STATISTIKOR I BIBLITEKAVE PËR VITIN 2022

I. FONDI LIBRAR NË BIBLIOTEKA AMË

Në gjuhën	Shqipe	Serbe	Turke	Të tjera	Gjithsej
	13014	11138	/	622	24920

II. FONDI LIBRAR NË DEGË

	Degët	Shqipe	Serbe	Turke	Të tjera	Gjithsej
1	Biblioteka publike dega në Bresanë	9013	439	/	170	9073
2	Biblioteka publike dega në Bellohrad	6611	///	///	22	6631
3	Biblioteka publike dega në Brezne	8363	/	/	/	8386
4	Biblioteka publike dega në Krushevë	298	4784	44	175	5301

5	Biblioteka publike dega në Brod	22	5003	79	169	5273
6	Biblioteka publike dega në Blaç	4480	/	/	/	4480
	Gjithsej	28787	21362	123	536	39144

III. FONDI LIBRAR NË BIBLIOTEKA AMË DHE NË DEGË

<i>Në gjuhën</i>	<i>Shqipe</i>	<i>Serbe</i>	<i>Turke</i>	<i>Të tjera</i>	<i>Gjithsej</i>
Gjithsej	40801	21364	269	1158	64064
Numri i librave për fëmijë	Nuk janë të ndara	/	/	/	/
Numri i librave të blera	1506	/	/	/	1506
Numri i librave të blera për fëmijë		/	/	/	
Numri i librave të qitura jashtë përdorimit		/	/	/	3

IV. LEXUESIT DHE LIBRAT E LEXUARA SIPAS PËRBËRJA SOCIALE

<i>Në bibliotekat amë</i>	<i>Nxënës</i>	<i>Studentë</i>	<i>Punëtorë/e</i>	<i>Bujq</i>	<i>Amvise</i>	<i>Të tjerë</i>	<i>Gjithsej</i>
Numri i lexuesve	667	26	50	///	///	30	773
Numri i librave të lexuara	1078	79	109	///	///	64	1330

Në degë

Numri i lexuesve	877	37	133	///	///		Gjithsej
							1047
Numri i librave të lexuara	1664	84	169	///	///		1917

Në bibliotekën amë dhe degë

Numri i lexuesve	1544	63	183	///	///	30	Gjithsej
							1820
Numri i librave të lexuara	2742	163	278	///	///	64	3247

V. LEXUESIT DHE LIBRAT E LEXUARA SIPAS PËRBËRJËS NACIONALE

<i>Në bibliotekat amë</i>	<i>Shqiptarë</i>	<i>Serbë</i>	<i>Boshnjakë/Goran</i>	<i>Turq</i>	<i>Të tjerë</i>	<i>Gjithsej</i>
Numri i lexuesve	653	///	20	///	///	673
Numri i librave të lexuara	1282	///	48	///		1330

Në degë

Numri i lexuesve	1084	///		///	///	1084
Numri i librave të lexuara	1917	///		///	///	1917

Gjithsej

Numri i lexuesve	1996	///	20	///	///	1757
Numri i librave të lexuara	3610	///	48	///	///	3247

Në kuadër të Memorandumit të Mirëkuptimit të nënshkruar mes Komunës së Dragashit dhe të Projektit të ReLOaD2 (Programit Rajonal për Demokracinë Lokale në Ballkanin Perëndimor 2), që financohet nga Bashkimi Evropian dhe zbatohet nga Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDP), është shpallur Thirrje Publike për OJQ- të dhe Thirrje për aplikim për “Udhëheqës i komunitetit të të rinjve”. Programi ReLOaD2 synon të promovojë angazhimin e të rinjve në mënyrë që të bëhen pjesë e proceseve vendimmarrëse në funksion të zhvillimit të komunitetit. Në kuadër të kësaj, ReLOaD2 ka planifikuar të rris përfshirjen e të rinjve përmes identifikimit dhe angazhimit vullnetar të “Udhëheqësve të komunitetit të të rinjve” në promovimin dhe zbatim e nismave rinore. Udhëheqësit e komunitetit të të rinjve do të angazhohen për të ndihmuar në mbajtjen e forumeve tematike dhe diskutimeve me qëllim identifikimin e çështjeve kryesore për të rinjtë në komunitetet lokale dhe t’i nxisin të rinjtë që të marrin pjesë në çështjet dhe aktivitetet e komunitetit të tyre.

Krahas realizimit të aktiviteteve të parapara me planin e punës, drejtoresha e DKRS ka pas një bashkëpunim të vazhdueshëm me Ministrinë e Kulturës, Rinisë e Sportit dhe shumë organizata të tjera ku janë dorëzuar edhe shumë kërkesa për mbështetje materiale në të gjithë sektorët duke përfshirë edhe bibliotekat, muzeun etnografik dhe restaurimin e objekteve të trashëgimisë kulturore e historike.

Gjithashtu në vazhdimësi ka marrë pjesë në mbledhjet e Qeverisjes Komunale, Mekanizmin Komunal Kundër Dhunës në familje, takimet publike, takime me përfaqësues të federatave të sportit e klube sportive si dhe organizata rinore. Gjithashtu kemi pasur bashkëpunim të ngushtë me Drejtorinë Komunale të Arsimit në organizimin e aktiviteteve të përbashkëta si dhe në lidhje me reformat dhe kushtet që mund t’i kenë të rinjtë.

Drejtorja ka ofruar raporte për Kryetarin e Komunës, informata për Kuvendin Komunal, komitetet përkatëse, Ministrinë e Kulturës, Rinisë e Sportit, organizatat vendore e ndërkombëtare. Me rastin e organizimit të aktiviteteve Drejtorja ka pasur mbështetje edhe nga partnerë të tjerë si: Policia e Kosovës, Ministria për Kulturë Rini dhe Sport, dhe disa OJQ lokale që kanë ndikuar në masë të madhe në numrin e aktiviteteve, suksesin dhe kualitetin e tyre.

Drejtorja për Kulturë, Rini e Sport

Drejtoresha

Liridona Misinaj





Republika e Kosovës
Republika Kosova/ Republic of Kosovo
Komuna e Dragashit/ Opština Dragaš/ Dragash Municipality
Drejtoria për Kulturë, Rini e Sport



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
Komuna e Dragashit
Opština Dragaš
02 Nr. Br. 020/01-1133/23
11.01. 2023
Dragash - Dragaš

Plani i punës për vitin 2023

Në përputhje me Statutin e Komunës, detyrat e përgjegjësitë e saj ligjore, Drejtoria e Kulturës, Rinisë e Sportit paraqet planin e punës për vitin 2023 mbi bazën e këtyre aktiviteteve:

- *Flaka e Janarit*
- *17 Shkurti- Dita e Pavarësisë së Republikës së Kosovës*
- *5 Marsi – Epopeja e UÇK-së*
- *7 Prilli – Dita Ndërkombëtare e Sportit dhe Paqes*
- *5 Maj dita e Dëshmorëve*
- *6 Maj dita e Goranëve*
- *9 Maji - Dita e Evropës*
- *Festivali Rinor*
- *Ora letrare kushtuar Ymer Prizrenit*
- *15 Qershori - Dita e Çlirimit të Dragashit (gara e pehllivanëve dhe vrapimi i kuaqjve)*
- *Festivali „Opoja Vallëzon“*
- *Ditët e Diasporës*
- *28 Shtatorë dita e Boshnjakëve*
- *Dita e Rinisë*
- *28 Nëntori - Dita e Flamurit kombëtar*
- *Bashkëpunimi me Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit për realizimin e projekteve për të gjithë sektorët, sa herë që paraqiten kërkesat*
- *Subvencionimi i organizatave dhe klubeve sportive ekzistuese*
- *Themelimi i klubeve të reja sportive dhe ofrimi i mbështetjes materiale për ato*
- *Përmirësimi i infrastrukturës sportive*
- *Do të vazhdohet bashkëpunimi me OJQ-të ndërkombëtare e vendore për restaurimin e objekteve të trashëgimisë kulturo- historike*

- *Furnizimi me libra i bibliotekave*
- *Organizimi i javës së bibliotekës në nivel qendror dhe lokal*
- *Renovimi i objekteve të bibliotekave dhe shtëpive të kulturës*
- *Ndërtimi i objektit të ri për bibliotekën në Dragash*
- *Hartimi dhe finalizimi i politikave e projekteve për zhvillimin dhe edukimin e të rinjve*
- *Shënimi i 1 Qershorit – Dita e fëmijëve*
- *Në bashkëpunim me Zyrën Ligjore do të intensifikohen angazhimet për hartimin e rregullores për licencimin dhe mënyrën e funksionimit të Qendrave Rinore në territorin e Komunës së Dragashit, funksionalizimin e Këshillit të Veprimit Rinor Lokal (KVRL), duke qenë se procesi ende nuk është përfunduar*
- *Miratimi i Planit të Veprimit Rinor Lokal në Asamblenë Komunale*
- *Hartimi dhe miratimi i Statutit të Muzeut Etnografik në Asamblenë Komunale*
- *Në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës, do të intensifikohen angazhimet për vazhdimin e punimeve të Palestrës Sportive*
- *Do të bashkëpunohet dhe do t'u ofrohet ndihmë të gjithë individëve e shoqatave, apo klubeve me karakter kulturor, sportiv dhe rinor në territorin e komunës*
- *Do të bëhen përpjekje për sigurimin e mjeteve për aktivitete sportive me punëtorët dhe zyrtarët e të gjitha drejtorive në kuadër të Komunës së Dragashit*
- *Do të shtohet angazhimet për mbarëvajtjen dhe kryerjen me përgjegjësi të punëve e detyrave të të gjithë zyrtarëve dhe punëtorëve të DKRS-së*

Drejtoria për Kulturë, Rini e Sport
Drejtoresha
Liridona Misinaj





Republika e Kosovës
Republika Kosova/ Republic of Kosovo
Komuna e Dragashit/ Opština Dragaš/ Dragash Municipality
Drejtoria për Kulturë, Rini e Sport



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
Komuna e Dragashit
Opština Dragaš
07 Nr. Br. 020/04-1133/23
11.01.2023
Dragash - Dragaš

Plani i punës për vitin 2023

Në përputhje me Statutin e Komunës, detyrat e përgjegjësitë e saj ligjore, Drejtoria e Kulturës, Rinisë e Sportit paraqet planin e punës për vitin 2023 mbi bazën e këtyre aktiviteteve:

- *Flaka e Janarit*
- *17 Shkurti- Dita e Pavarësisë së Republikës së Kosovës*
- *5 Marsi – Epopeja e UÇK-së*
- *7 Prilli – Dita Ndërkombëtare e Sportit dhe Paqes*
- *5 Maj dita e Dëshmorëve*
- *6 Maj dita e Goranëve*
- *9 Maji - Dita e Evropës*
- *Festivali Rinor*
- *Ora letrare kushtuar Ymer Prizrenit*
- *15 Qershori - Dita e Çlirimit të Dragashit (gara e pehlivanëve dhe vrapimi i kuajve)*
- *Festivali „Opoja Vallëzon“*
- *Ditët e Diasporës*
- *28 Shtatorë dita e Boshnjakëve*
- *Dita e Rinisë*
- *28 Nëntori - Dita e Flamurit kombëtar*
- *Bashkëpunimi me Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit për realizimin e projekteve për të gjithë sektorët, sa herë që paraqiten kërkesat*
- *Subvencionimi i organizatave dhe klubeve sportive ekzistuese*
- *Themelimi i klubeve të reja sportive dhe ofrimi i mbështetjes materiale për ato*
- *Përmirësimi i infrastrukturës sportive*
- *Do të vazhdohet bashkëpunimi me OJQ-të ndërkombëtare e vendore për restaurimin e objekteve të trashëgimisë kulturo- historike*

- *Furnizimi me libra i bibliotekave*
- *Organizimi i javës së bibliotekës në nivel qendror dhe lokal*
- *Renovimi i objekteve të bibliotekave dhe shtëpive të kulturës*
- *Ndërtimi i objektit të ri për bibliotekën në Dragash*
- *Hartimi dhe finalizimi i politikave e projekteve për zhvillimin dhe edukimin e të rinjve*
- *Shënimi i 1 Qershorit – Dita e fëmijëve*
- *Në bashkëpunim me Zyrën Ligjore do të intensifikohen angazhimet për hartimin e rregullores për licencimin dhe mënyrën e funksionimit të Qendrave Rinore në territorin e Komunës së Dragashit, funksionalizimin e Këshillit të Veprimit Rinor Lokal (KVRL), duke qenë se procesi ende nuk është përfunduar*
- *Miratimi i Planit të Veprimit Rinor Lokal në Asamblenë Komunale*
- *Hartimi dhe miratimi i Statutit të Muzeut Etnografik në Asamblenë Komunale*
- *Në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës, do të intensifikohen angazhimet për vazhdimin e punimeve të Palestrës Sportive*
- *Do të bashkëpunohet dhe do t'u ofrohet ndihmë të gjithë individëve e shoqatave, apo klubeve me karakter kulturor, sportiv dhe rinor në territorin e komunës*
- *Do të bëhen përpjekje për sigurimin e mjeteve për aktivitete sportive me punëtorët dhe zyrtarët e të gjitha drejtorive në kuadër të Komunës së Dragashit*
- *Do të shtohet angazhimet për mbarëvajtjen dhe kryerjen me përgjegjësi të punëve e detyrave të të gjithë zyrtarëve dhe punëtorëve të DKRS-së*

Drejtoria për Kulturë, Rini e Sport
Drejtoresha
Liridona Misinaj






REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVO-
REPUBLIC OF KOSOVO

KUVENDI KOMUNAL DRAGASH – SKUPŠTINA OPŠTINE DRAGAŠ-
MUNICIPALITY OF DRAGASH

**DREJTORIA E MBROJTJES, SHPËTIMIT DHE
SHËRBIMEVE PUBLIKE**

RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2022

DHE

PLANI I PUNËS PËR VITIN 2023



RAPORTI I PUNËS

Drejtorijati për Mbrojtje, Shpëtim dhe Shërbime Publike për vitin 2022

Veprimtaritë e ndërmarra të Drejtorisë së Mbrojtjes, Shpëtimit dhe Shërbimeve Publike (në tekstin e mëtejshëm DMSHSHP) në vitin 2022, kryesisht bazohet në aktivitetet e planifikuara për vitin 2022, si dhe në rrethana dhe ngjarje të tjera gjatë vitit, bazuar në dokumentet përkatëse për funksionimin e Drejtorisë, dhe të gjitha me qëllim të punës efektive në fushën e mbrojtjes së jetëve njerëzore, të mirave materiale, pronë dhe mjedis.

DMSHSHP-ja e zhvilloi aktivitetin e saj në kuadër të angazhimit të strukturave që zotëron dhe të cilat bashkëpunojnë vazhdimisht në varësi të situatave me të cilat përballen në punën e tyre të përditshme.

Drejtorja është e përfshirë në punën e shtabit komunal dhe Komitetit për Siguri në Bashkësi dhe merr pjesë aktive në të gjitha diskutimet dhe analizat si dhe në aktivitetet e nevojshme siç janë aktivitetet rreth rrëshqitjes së dheut në Restelicë dhe ndërtimi i murit mbrojtës bazuar në bashkëpunimin dhe Rekomandimi i Institutit Gjeologjik të Kosovës, pastaj rreth kërkimit të personit të zhdukur nga Borja, apelohet për vëmendje të shtuar nga zjarret gjatë sezonit veror, aktivitete për situata emergjente, shqyrtimi dhe zbatimi i vendimeve të Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës, si dhe të Ministrisë së Shëndetësisë si brenda drejtorisë ashtu edhe në vetë komunitetin, të gjitha me qëllim të ruajtjes së një situatë të mirë të sigurisë në komunën tonë.

Komunikimi me KFOR-in ka vazhduar për çështje të rëndësishme për sigurinë e komunës sonë, e cila është jashtëzakonisht e rëndësishme për sigurinë e qytetarëve të komunës së Dragashit.

Obligim i drejtorisë është edhe përcaktimi i dëmit të shkaktuar nga faktorët natyrorë, në këtë drejtim, komisioni komunal për vlerësimin e dëmeve me kohë dhe me sukses ka dalë në vendin e ngjarjes pas kërkesave të palëve dhe ka përgatitur raport për gjendjen e faktike.

Të gjitha procedurat e brendshme në komunë janë realizuar me sukses dhe bashkëpunimi i DMSHSHP me drejtoritë tjera ka qenë në përputhje me nevojat.

Gjatë vitit 2022, komuna e Dragashit ka bërë përparim të madh në sferën e menaxhimit të mbeturinave, si rezultat i bashkëpunimit të vazhdueshëm të drejtorisë sonë me Organizatën Japoneze JICA për bashkëpunim ndërkombëtar. Komuna jonë është e përfshirë në projektin trevjeçar “Projekti për përmirësimin e kapaciteteve për menaxhimin e mbeturinave drejt një shoqërie të shëndetshme-faza II”, me qëllim kryesor të projektit të lartpërmendur përcaktimin dhe aplikimin e metodave të reja në bashkëpunim me ekspertë nga Japonia me qëllim të përmirësimit të menaxhimit të mbeturinave të ngurta për komunitat e vogla dhe të mesme (që përfshin komunën e Dragashit).

Implementimi i pilot projekteve është rënë dakord në procesverbalin e takimit të nënshkruar më 18 shkurt 2022 ndërmjet organeve kompetente, përfshirë Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, katër komunitat në projekt dhe JICA.

Ky aktivitet është një tjetër kontribut i rëndësishëm i drejtorisë sonë për zgjidhjen e problemit të mbeturinave në territorin e komunës sonë. Gjegjësisht, fillimisht me iniciativë të drejtorisë është formuar grupi punues i komunës, i cili së bashku me kompaninë "Ekoregjioni" në Dragash, në bashkëpunim me JICA, kanë marrë pjesë në realizimin e 4 pilot projekteve që kanë të bëjnë me përmirësimin e sistemi i menaxhimit të mbetjeve në komunën tonë, si dhe trajtimi i tij, dhe kështu DMSHSHP ka ndikuar drejtpërdrejt në përmirësimin e shërbimeve të ofruara nga "Ekoregjioni", sepse falë angazhimit tonë dhe donacioneve nga Organizata Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar, Kompania e Menaxhimit të Mbeturinave “Ekoregjioni” ka marrë një buldozher për t’u përdorur në deponin komunale, peshorja që mungonte në deponi dhe që do të ndikojë shumë në funksionimin e mëtejshëm efikas të deponisë sepse sasia e mbeturinave të depozituara në deponi do të dihet saktësisht dhe kështu do të ndikojë në funksionimin e mëtejshëm dhe planifikimin e kapaciteteve të të njëjtit. Për hir të një strategjie më të mirë të menaxhimit të deponisë, DMSHSHP u përfshi në vizita studimore në Mal të Zi dhe Bullgari.

Po ashtu, komuna jonë në bashkëpunim me GIZ-in, “Ekoregjionin” dhe Asociacionin e Komunave të Kosovës është përfshirë në procesin e identifikimit të deponive ilegale (mbi 100 pika të zeza). Angazhimi i mëtejshëm është i nevojshëm për zgjidhjen e problemit të deponive ilegale në territorin e komunës sonë.

Për të krijuar kushte për trajtim sa më të mirë të mbeturinave në deponi, Komuna realizoi një projekt për kullimin e ujit në lagunën ekzistuese, më pas është bërë mbjellja e fidaneve të pishës përreth deponisë, si dhe një projekt për elektrifikimin e deponisë, i cili deri në këtë moment ka funksionuar pa energji elektrike, pra me agregate kur ishte e nevojshme energjia elektrike.

Në vetë ndërtesën e Komunsë nuk funksionon sistemi i alarmimit dhe njoftimit në kohë në raste emergjente (alarm) dhe nuk ka asnjë zyrtar të punësuar në drejtori pas pensionimit të zyrtarit të mëparshëm, kështu që edhe këtë problem e kemi trajtuar me synimin për të gjetur një mekanizëm për riparimin e të njëjtit. Në vitin e ardhshëm do të punohet për rifunksionalizimin dhe rikthimin e tij në gjendjen e duhur, pas testimit paraprak.

ZJARRFIKËSIT DHE SHËRBIMET EMEREGJENTE

Njësia Profesionale e Zjarrfikësve dhe Shpëtimit e Komunës së Dragashit, në kuadër të aktiviteteve të shumta në kuadër të fushëveprimit të saj, në përputhje me ligjin dhe dokumentet përkatëse, me sukses i ka përmbushur obligimet dhe misionin e saj për mbrojtjen e jetës së njerëzve, të mirave materiale dhe pronës së qytetarëve. Ndonëse përballet me sfida të shumta dhe me numër të pamjaftueshëm të personelit, Shërbimi Zjarrfikës ka treguar përgjegjësi dhe përshtatshmëri.

Nga statistikat e vitit të kaluar, konfirmohet se masat dhe aktivitetet e ndërmarra kanë dhënë rezultate pozitive dhe se numri i intervenimeve të Shërbimit është ulur ndjeshëm.

Një nga vështirësitë e spikatura që krijon probleme dhe stagnim për njësinë në aktivitetin real është padyshim vendosja e hidrantëve në fshatra, si dhe numri i pamjaftueshëm i personelit (punëtorëve), prandaj është e nevojshme të rritet numri i punëtorëve me 8 zjarrfikësve, në përputhje me standardet AME, të paktën gjysma e atyre punëtorëve me patentë shofer të kategorisë “C”, në mënyrë që puna e Shërbimit Zjarrfikës të ishte edhe më e suksesshme. Duke pasur parasysh se qendra e Dragashit është deri në 25 km larg disa fshatrave, gjë që e bën të pamundur ndërhyrjen e shpejtë dhe efikase.

Një nga dukuritë me të cilat ndeshet shpesh Shërbimi Zjarrfikës janë zjarret që shkaktojnë dëme të mëdha. Si masë e detyrueshme, për ndalimin, nëse është e mundur, dhe minimizimin e zjarrit, Shërbimi Zjarrfikës mori masa parandaluese: apel për vëmendje të shtuar në trajtimin e zjarrit, d.m.th. mjetet ndezëse, informimi i popullatës për dëmet që mund të shkaktojnë zjarret, ligjërata nga imamët në xhamitë komunale, shkolla, diskutime me shoqata, shoqëri dhe palë të tjera të interesuara.

Shërbimi zjarrfikës ka intensifikuar vëzhgimin e terrenit në të gjithë territorin e komunës dhe ka parandaluar zjarr vënien e qëllimshme. Vëzhgimet dhanë rezultate të dukshme dhe pozitive që tregojnë një ulje të përqindjes së ndërhyrjeve gjatë vitit kalendarik. U harxhua më shumë lëndë djegëse, por dëmi i mundshëm i shkaktuar nga shkatërrimi i pyjeve, vlera e të cilave është e pallogaritshme, u ul ndjeshëm.

Trevat që po monitorohen me vëmendje janë:

Bjeshka e Koritnikut, Bjeshka e Zymit, rrethina e Pllavës, Buçës, Breznës, Kukulanit, Brrutit, Orçushës, Mejdani i Buzezit, Llopshnikut dhe të gjitha bjeshkët e tjera në përgjithësi, sidomos territoret pranë vendbanimeve.

Në vitin 2022 në komunën tonë kanë ndodhur 117 zjarre, 18 ndërhyrje teknike dhe 41 shërbime.

Në disa raste janë bërë ndërhyrje për nxjerrjen e ujit nga podrumi në ndërtesën e vjetër të postës, ku ka pasur ujë deri në gjysmën e podrumit prej kur ekziston ky objekt. Ky problem u zgjidh përgjithmonë me ndërhyrjen dhe instalimin, gjë që ja ka zgjatur afatin kësaj ndërtese.

Në bazë të zjarreve të shumta gjatë stinës së verës, mund të konstatohet se për një qasje më serioze ndaj këtij problemi nevojitet përfshirja më e madhe e strukturave komunale, enteve të tjera të sigurisë, bizneseve, shoqatave, shoqërive dhe qytetarëve. Prandaj, në planin për vitin e ardhshëm kemi përfshirë aspiratën për punësimin e 8 zjarrfikësve shtesë, qoftë edhe në baza sezonale, për të qenë më të suksesshëm në punën e tyre. Gjithashtu, në planin për vitin e ardhshëm, kemi punë në formimin e ekipeve vullnetare për të cilat do të përgatiteshin kurse profesionale për trajnim për punë në situata emergjente, gjatë të cilave përvoja dhe njohuritë e marra shumëvjeçare për zjarret dhe dukuritë tjera negative. për sigurinë e pronave, jetëve njerëzish dhe të mirave materiale.

Theks të veçantë kemi për barinjte në kullotat nëpër bjeshkë, banorët e Shqipërisë që jetojnë rreth kufirit (duke mbledhur fruta të ndryshme nëpër bjeshkë) të mos dëmtojnë florën dhe faunën (të mos ndezin zjarre, apo të dëmtojnë fizikisht shkurret dhe bimë të tjera) sepse është e pamundur ndërhyrja e Shërbimit Zjarrfikës nëpër bjeshkë.

Shërbimi Zjarrfikës përcaktoi zonat më të rrezikshme në të cilat zjarret në përmasa të mëdha do të shkaktonin dëme të konsiderueshme dhe njoftoi menjëherë të gjitha subjektet kompetente që merren me çështjen e sigurisë së përgjithshme që t'i kushtojnë vëmendje të veçantë problemit të zjarrit si pjesë e obligimeve të tyre.

Shërbimi Zjarrfikës ka njoftuar Kuvendin Komunal, Drejtoritë dhe institucionet që të angazhohen seriozisht në ofrimin e ndihmës për Zjarrfikësit si dhe marrjen e masave për angazhimin më të suksesshëm të Departamentit. Komuna pjesërisht u përgjigj me apele të duhura dhe duke vënë theksin në trajtimin e kujdesshëm të zjarrit, i cili, sipas raportit, sigurisht që dha rezultat, krahas aktiviteteve të tjera.

SHËRBIMI EMERGJENTE

Raporti për punën e zyrtarit të shërbimit publik bazohet në planin e punës së drejtorisë për shërbime publike, përshkrimin e detyrave të parapara për zyrtarin e shërbimit publik, si dhe në bazë të nevojave të tjera të drejtorisë, varësisht nga situata përgjatë vitit.

Një nga detyrat kryesore të parashikuara në kontratën e punonjësve të shërbimit publik është pjesëmarrja në organizimin dhe zhvillimin e planit të punës së drejtorisë për vitin 2023, si dhe krijimi i raportit të përgjithshëm vjetor të drejtorisë për vitin 2022 në bashkëpunim me drejtorin dhe zyrtarët e tjerë të drejtorisë.

Zyrtari i Shërbimeve Publike mban komunikim me shërbimet përkatëse në kuptim të koordinimit të veprimeve dhe harmonizimit të aktiviteteve.

Mban bashkëpunim të vazhdueshëm me kompanitë që janë përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve publike në komunën tonë, përkatësisht me kompaninë “Ekoregjioni” që është përgjegjëse për menaxhimin e mbeturinave në komunën tonë, të gjitha me qëllim të përmirësimit të këtij shërbimi, si dhe me kompaninë “Hidroregjioni” lidhur me furnizimi me ujë dhe kanalizim në komunën e Dragashit, ndërsa sa i përket mirëmbajtjes të rrugëve në sezonën dimërore, d.m.th. pastrimin e borës, këtë vit drejtorja e ka menaxhuar vetë këtë aksion të pastrimit dhe mirëmbajtjes së rrugëve lokale sepse disponon makineritë e nevojshme për pastrimin e borës.

Gjatë punës këtë vit, theksi kryesor ka qenë në menaxhimin e mbeturinave përmes projektit katërvjeçar për përmirësimin e kapaciteteve për menaxhimin e mbeturinave të ngurta drejt një shoqërie të shëndetshme faza II 2021 - 2024, e gjitha me synimin për të përmirësuar këtë shërbim, duke përmirësuar cilësinë e jetesës dhe ruajtjen e mjedisit tonë.

Në projektin e sipërpërmendur, zyrtari i shërbimit publik është i përfshirë drejtpërdrejt në katër pilot projekte, konkretisht:

1. Pilot projekti 1 “Futja e edukimit mjedisor dhe sistemit të riciklimit” anëtar i grupit punues si dhe koordinator për shkollat e përfshira në këtë projekt nga pjesa gorës.
Në shkollat e përfshira në këtë pilot projekt, në bashkëpunim me Drejtorinë e Arsimit, është futur një sistem i ri riciklimi ku nxënësit do të mbledhin lëdnët e riciklueshme (shishe PET, kanaçe, shishe qelqi etj.) në kontenjer riciklimi dhe t’i shesin në një kompani lokale riciklimi dhe fitimi nga shitja mund të përdoret për të blerë pajisje arsimore. Mësuesit zbatojnë programin e edukimit mjedisor. Rezultatet dhe përvojat do të ndahen me shkollat e tjera në seminare.

2. Pilot projekti 2 “Përmirësimi i sistemit të menaxhimit të mbeturinave në fshatin Brod” koordinator i projektit.

Për zgjerimin e shërbimit të grumbullimit të mbeturinave dhe përfshirjen e fshatit Brod në sistemin e menaxhimit të mbeturinave, është bërë analiza e shkaqeve të mos grumbullimit (fizik, social, ekonomik, etj.) të mbeturinave, është hartuar plani fizibiliteti, duke përfshirë zhvillimin e një sistemi për grumbullimin, transportin, asgjësimin dhe një program ndërgjegjësimi për zgjerimin e zonave të grumbullimit.

Është krijuar një pikë grumbullimi. Është përgatitur kontrata ndërmjet kompanisë “Ekoregjioni”, komunës dhe OJQ-së “Zajeno za Brod” për menaxhimin e mbeturinave në fshatin Brod, si dhe kontratë me organizatën joqeveritare të lartpërmendur për shfrytëzimin e një automjeti të komunës (damper) për grumbullimin e mbeturinave në fshatin Brod, i cili gjithashtu është donacion nga JICA.

Početak druge faze ovog pilot projekta se očekuje na Proleće 2023. godine.

3. Pilot projekti 3 “Përmirësimi i deponisë përfundimtare” bazuar në nevojat e drejtorisë.

Dragashi është e vetmja nga katër komunat që janë pjesë e projektit të lartpërmendur që ka deponinë e vet. Funksionimi aktual i deponisë është thjesht grumbullimi i mbeturinave duke shtyrë me buldozher dhe nuk ka ngjeshje, pra mbetjet shpërndahen në të gjithë deponin.

Për të përmirësuar këtë situatë, ekipi i ekspertëve të JICA-s ka ndihmuar në realizimin e ngjeshjes së shtresës së mbeturinave, formësimin e sipërfaqes së deponisë dhe menaxhimin e deponisë.

Përveç kësaj, instalimi i pajisjeve matëse, dmth. peshoret do të mundësojnë përcaktimin e sasisë së saktë të mbeturinave në deponi dhe të sigurojnë menaxhimin dhe vlerësimin e duhur të jetëgjatësisë së deponisë aktuale.

4. Pilot projekti 4 “Implementimi i reformave d.m.th. sistemi i pagesës së mbeturinave” anëtar i grupit punues komunal.

Aktualisht kompania “Ekoregjioni” është përgjegjëse për grumbullimin e mbeturinave komunale, duke bërë pagesë të drejtpërdrejt me qytetarë të cilëve u ofron shërbime.

Duke qenë se “Ekoregjioni” nuk ka mekanizma të mjaftueshëm për zbatim, nuk është në gjendje të sigurojë pagesën e plotë nga të gjithë qytetarët që i shërben, duke humbur të ardhura të konsiderueshme që ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë e shërbimeve të ofruara për qytetarët për të garantuar burime të mjaftueshme financiare për menaxhimin e mbeturinave komunale. Komuna duhet të marrë përgjegjësinë për mbledhjen e taksës për largimin e mbeturinave, sepse komuna posedon mjete më efikase për pagesën e taksës për shërbimet e grumbullimit të mbeturinave. Mbështetja do të jetë miratimi i një platforme të përbashkët elektronike për menaxhimin e tarifave për grumbullimin e mbeturinave, dhe zbatimi i këtij pilot projekti varet nga miratimi i

rregulloreve komunale për menaxhimin e mbeturinave dhe pritet të zbatohet në fillim të janarit 2024.

Aktivitetet që ishin planifikuar dhe kishin të bënin me mbajtjen e takimeve, seminareve, trajnimeve etj. u zbatuan në varësi të nevojave dhe pilot projekteve të sipërpërmendura.

Gjatë gjithë vitit janë mbajtur takime me këto organizata:

1. Ndërmarrja "Ekoregjioni", takime për bashkëpunimin e mëtejshëm për menaxhimin e mbeturinave,
2. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, menaxher i projektit katërvjeçar,
3. Organizata Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar JICA, takime dhe seminare në lidhje me projektin katërvjeçar të lartpërmendur,
4. OJQ "Eko Restelica" për gjendjen aktuale me mbeturinat si dhe bashkëpunimin e mundshëm,
5. OJQ "Zajeno za Brod" partner i pilot projektit 2 "Përmirësimi i sistemit të menaxhimit të mbeturinave në fshatin Brod",
6. Kompania softuerike Bbros për krijimin e softuerit të nevojshëm për zbatimin e reformës së grumbullimit të mbeturinave.

Gjithsej janë mbajtur 52 takime me organizatat e sipërpërmendura, si dhe 10 seminare dhe takime pune me tema që kanë të bëjnë me shërbimet publike.

Gjatë vitit 2022, zyrtari i shërbimeve publike ka qenë anëtar i disa komisioneve:

1. Komisioni i Riintegritimit,
2. Komisioni për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore dhe të tjera;
3. Komisioni i Pranimeve.

Si anëtar i komisionit për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore, në bazë të gjithsej 17 kërkesave të parashtruara, zyrtari i shërbimit publik ka shkuar në vendngjarje dhe ka konstatuar gjendjen faktike me anëtarët e tjerë dhe kryetarin e komisionit.

Secila palë që ka paraqitur kërkesë në zyrën e Drejtorisë për Shërbime Publike ka marrë përgjigje në rregull dhe kërkesat drejtuar komisionit për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore dhe gjëra të tjera i raportohen me rregull kryetarit të komisionit, i cili është përgjegjës për organizimin e komitetit dhe kohën e daljes në terren dhe raporteve.

Gjatë punës së mëtejshme, zyrtari i shërbimeve publike vazhdon të bashkëpunojë me të gjithë zyrtarët e drejtorisë dhe shërbimeve që i përkasin drejtorisë sonë dhe që ofrojnë shërbime publike për përmirësimin e përgjithshëm të punës dhe ofrimin e një shërbimi të plotë dhe cilësor.

MENAXHIMI I MBETURINAVE

Detyra kryesore e sektorit të menaxhimit të mbeturinave është bashkëpunimi me kompaninë “Ekoregjioni” me qëllim përmirësimin e ofrimit të shërbimeve të grumbullimit dhe largimit të mbeturinave. Gjatë vitit 2022 është shënuar progres i dukshëm në fushën e menaxhimit të mbeturinave në komunën tonë.

Kemi vazhduar bashkëpunimin e ngushtë në mes të Komunës dhe kompanisë së menaxhimit të mbeturinave “Ekoregjioni”, i cili pritet të vazhdojë edhe në të ardhmen. Në takimet me menaxhmentin e kompanisë “Ekoregjioni”, ne përpiqemi të gjejmë mënyrën më të mirë për të përmirësuar gjendjen e menaxhimit të mbeturinave në territorin e komunës së Dragashit.

Pas kamionëve që kemi marrë si donacion nga Japonia, më saktësisht Organizata Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar JICA, në vitet e kaluara, gjatë vitit nga e njëjta kompani kemi marrë të lartpërmendurat: peshore në deponi, buldozher për deponi, pikën grumbulluese në Brod dhe damper për grumbullimin e mbeturinave në Brod.

Qëllimi kryesor i drejtorisë në lidhje me menaxhimin e mbeturinave është zbatimi i planit pesëvjeçar tashmë të miratuar dhe zbatimi i të gjitha aktiviteteve të planifikuara fillimisht për vitin 2022. Ndër të tjera, është më e rëndësishme që të gjitha fshatrat në territorin e komunës sonë të përfshihen në sistemin e grumbullimit të mbeturinave, për të reduktuar numrin e deponive ilegale dhe për të rritur ndërgjegjësimin e qytetarëve për problemin dhe rëndësinë e menaxhimit të suksesshëm të mbeturinave.

Fillimi i këtij viti deri më tani ka qenë i ngarkuar sepse ne kemi vazhduar me punët dhe projektet që na takojnë dhe obligimet që kemi marrë për bashkëpunim me dy organizata të huaja që punojnë për përmirësimin e kushteve sa i përket menaxhimit të mbeturinave.

Organizatat që na ndihmojnë në këtë fushë janë: GIZ-i Gjerman dhe JICA Japoneze.

Ne kemi takime të vazhdueshme këshilluese me GIZ-in gjerman, gjithashtu së bashku me këtë organizatë kemi bërë një plan pesëvjeçar dhe për fat të mirë kemi biseduar edhe për ndryshimin, përmirësimin dhe rifreskimin e rregulloreve komunale, këto garanci janë marrë nga zyrtari i GIZ-it i cili premtoi se do të na ndihmojë.

Kjo organizatë do të vazhdojë të bashkëpunojë me komunën tonë si dhe me komunat tjera në lidhje me shumë këshilla dhe aktivitete dhe është duke shqyrtuar mundësinë e ndihmës tjetër. Ne nuk do ta ndërpresim bashkëpunimin me këtë organizatë. GIZ-i sigurisht që do të na ndihmojë në afat të gjatë me deponin, duke krijuar kushte më të mira, duke rritur kapacitetin e vetë të deponisë, e të ngjashme.

Një tjetër organizatë që na ka ndihmuar dhe ka një projekt me 4 komuna është JICA japoneze.

JICA ka një projekt që përfshin 4 komuna: Dragash, Malishevë, Rahovec, Suharekë.

Për fatin tonë të mirë, JICA ka vendosur të na ndihmojë edhe në 4 pilot projekte të tjera, gjë që kuptohet bashkë me Komunën dhe vullnetin e lartë të kryetarit dhe drejtorit të cilët janë të interesuar për bashkëpunim dhe investim në këtë fushë.

JICA i ka ndarë pilot projekte në disa pika, sipas tyre këto pika janë: PP1, PP2, PP3, PP4.

Këtë vit kemi qenë shumë të angazhuar me aktivitete sepse këtë vit kemi përfunduar gati më shumë se 50 për qind të projekteve, do të veçojmë disa punë që janë bërë së bashku në mes të Komunës dhe JICA-s.

Fillimisht, në bashkëpunim me Drejtorinë e Arsimit, nisëm një fushatë për sensibilizimin e nxënësve të shkollave fillore së bashku me zyrtarët dhe profesorët e JICA-s, ku arritëm me sukses në fund duke informuar nxënësit për deponitë e mbeturinave dhe mënyrën e ruajtjes së një mjedisi të pastër.

Zgjatja e jetëgjatësisë së deponisë filloi duke shtyrë, ngjeshur dhe mbuluar me tokë mbeturinat e vjetra që ndodheshin tashmë në vendgrumbullim për të përgatitur terrenin për deponimin e mëtejshëm të duhur të mbeturinave, të cilat në të ardhmen do të asgjësohen siç duhet, duke u ngjeshur dhe të mbuluar me dhe çdo ditë dhe në mënyrë që të zgjatet jeta e deponisë dhe deponija merr një formë piramidale përfundimtare sipas planeve të inxhinierëve të JICA.

Me realizimin e pilot projektit të përmirësimit të deponisë së lartëpërmendur, u vendos një peshore që do të përdoret për matjen e mbeturinave të hedhura, me ndihmën e komunës u hap drenazha e deponisë, u hap një pus uji për nevojat e deponisë, ka përfunduar mbjellja e fidanëve të pishës dhe pritet përfundimi i projektit të furnizimit me energji elektrike për deponin.

Këtë vit vazhdoi fushata për futjen e fshatrave të mbetura në sistemin e menaxhimit të mbeturinave, ndaj në bazë të pilot projektit 2 “Përmirësimi i sistemit të menaxhimit të mbeturinave” në bashkëpunim me JICA dhe kompaninë “Ekoregjioni” filluam me menaxhimin e mbeturinave në fshatin Brod, ku është ndërtuar një pikë grumbullimi prej materiali të ngurtë e pajisur me 16 kontejnerë, dhe DMSHSHP do të sigurojë një automjet për grumbullimin e mbeturinave komunale (dumper) dhe do ti jepet në shërbim një organizate joqeveritare që do të mbledhë mbeturinat në fshat dhe do t'i transportojë ato në vend grumbullim, ku në fund të javës nga

pika e grumbullimit, mbeturinat do të transportohen në deponin komunale nga ana e kompanisë "Ekoregjiono".

Kemi hulumtuar edhe deponitë ilegale, që tek ne është një dukuri shumë e zakonshme, në bazë të situatës në terren dhe fotove, shohim gjendjen reale me të cilën po përballet komuna jonë.

Të gjithë së bashku po mundohemi që të bëjmë më tepër për një mjedis më të pastër, sepse Komuna jonë konsiderohet si një nga pikat turistike në vend.

Vërejtje:

Raporti i Drejtorisë së Mbrojtjes, Shpëtimit dhe Shërbimeve Publike për vitin 2022 bazohet në raportet individuale të të gjithë punonjësve të Drejtorisë.

Janar 2023

Drejtore: Nuhija Tairovci



PLANI I PUNËS

Drejtoria e Mbrojtjes, Shpëtimit dhe Shërbimeve Publike për vitin 2023

Duke u thirrur në përgjegjësi të Drejtorisë, më konkretisht të përcaktuara në nenin 67 të Statutit të Komunës së Dragashit, si dhe përvojës së fituar nga terreni, Drejtoria parasheh planin e punës në si vijim për vitin 2023, me të cilin do të përgjigjen ndaj kërkesave dhe sfidave në vitin aktual.

Nr	Përgjegjësitë	Aktivitetet	Koha e realizimit sipas tremujorëve			
1.	Shërbimet e zjarrfikësve dhe emergjencave	1. Forcimi i kapaciteteve të zjarrfikësve, që funksionon në kuadër të Drejtorisë, në kuptim të Planit të Trajnimit të parashikuar nga AME/MPB për vitin 2023.	X	X	X	X
		2. Përmirësimi i kushteve të punës, pajisjeve dhe shtimi i numrit të zjarrfikësve dhe automjeteve për të qenë plotësisht i përgatitur për veprime në kohë dhe të suksesshme për shuarjen e zjarreve dhe rreziqeve të tjera të mundshme për popullatën dhe të mirat publike.	X	X	X	X
		3. Ndërmarrja e masave konkrete me veprime parandaluese në parandalimin e rreziqeve, si dhe mbrojtjen e qytetarëve dhe pronës. Si masë parandaluese, një vizitë nëpër vendbanimet e Komunës dhe ngritja e nivelit të informimit përmes mediave lokale.	X	X	X	X
		4. Për të siguruar kapacitetin dhe gatishmërinë e mbrojtjes nga zjarri në periudhën e verës kur rreziku i zjarrit është i lartë në të gjithë komunën, të punësohen disa punëtorë	X	X	X	X

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
Komuna e Dragashit
Opština Dragash

08 Nr. Br. 020/21- 955423
31.01.2023
Dragash - Dragash

		sezonalë (në përputhje me vlerësimin në momentin e caktuar) dhe të kryhet trajnimi i tyre.				
2.	Vlerësimi, njoftimi dhe alarmimi i popullatës në rast të kërcënimeve dhe rreziqeve, organizimi dhe mirëmbajtja e mjeteve të alarmimit në sistemin e unifikuar të alarmit, si dhe funksionimi i komunikimeve për nevojat e mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës në përputhje me sistemin e unifikuar të lidhjeve.	1. Duke qenë se zyra për lidhje pranë drejtorisë nuk është aktive për një periudhë të caktuar kohore (dalja në pension e punonjësit), në përputhje me mundësitë ligjore, të punësohet një punonjës për këtë pozicion vakant. Meqenëse sistemi i alarmit nuk funksionon, të kthehet sirena e alarmit dhe sistemin e kontrollit në funksion sa më shpejt të jetë e mundur. Gjithashtu në mungesë të punonjësit të komunikimit do të përpiqemi të përmirësojmë situatën në sektorin e komunikimit (prokurimi dhe vënia në funksion e Motorolës për komunikim të brendshëm në situata emergjente)	X	X	X	X
		2. Përditësimi i të dhënave të fatkeqësive natyrale dhe elementare në të gjithë territorin e Komunës, bazuar në informacione të terrenit dhe eksperiencën nga vitet e mëparshmet.	X	X	X	X
		3. Vazhdimi i komunikimit me shërbimet përkatëse në drejtim të bashkërendimit të veprimeve dhe bashkërendimit të aktiviteteve, ndihmës reciproke për realizimin e synimeve të përcaktuara. (QKMF, Policia, KFOR, Kryqi i Kuq, Shkollat, AME, Shërbimi Gjeologjik i Kosovës, etj.)	X	X	X	X

3.	Planifikimi dhe zbatimi i masave mbrojtëse për mbrojtje dhe shpëtim, si dhe vlerësimi i rrezikut dhe zhvillimi i planeve kundër fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të tjera	1. Në bashkëpunim më të mirë me Drejtorinë për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor, të përfshihet në listën e investimeve kapitale, ndërtimi i mureve mbrojtëse dhe rrjeteve në vendet më të rrezikshme, me qëllim të parandalimit të rrëshqitjeve dhe mureve mbrojtëse për parandalimin e vërshimeve, me qëllim të parandalimit e pasojave të mundshme..	X	X	X	
		2. Përditësimi i vlerësimit të rrezikut duke i dorëzuar KK-së propozim për marrjen e vendimit, bazuar në rekomandimet nga raporti i Shërbimit Gjeologjik të Kosovës.		X		
		3. Në kuadër të mundësive, është e nevojshme të angazhohet (punësohet) bashkëpunëtor profesional për planifikimin dhe menaxhimin e situatave emergjente, si dhe inspektor i mbrojtjes nga zjarri.				
4.	Propozimi i krijimit të Komitetit për Mbrojtjen dhe Shpëtim nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e tjera, Komitetet Organizative, Njësitë dhe Shërbimet e Forcave për Mbrojtje, Shpëtim dhe Ndihmë	1. Drejtoria do të propozojë ngritjen e një komiteti të mbrojtjes dhe shpëtimit për shkak të nevojës për krijimin dhe koordinimin e një ekipi emergjence.	X			
5.	Bashkëpunimi me komunat fqinje për ofrimin e shërbimeve për mbrojtje nga	1. Komunikimi me drejtorinë në komunën e Prizrenit, por edhe me të tjerët në rajon dhe takime të mundshme me qëllim të marrëveshjes së shërbimeve për veprim të	X	X	X	X

	fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera	përbashkët në situata emergjente dhe ofrimin e ndihmës së ndërsjellë.				
6.	Ofrimi i shërbimeve publike dhe infrastrukturore duke përfshirë transportin lokal, mirëmbajtjen e rrugëve, furnizimin me ujë, ujësjellës kanalizime, menaxhimin e mbeturinave.	Vazhdimi bashkëpunimi me :				
		1. Keds .	X	X	X	X
		2. " Hidroregjioni" rreth furnizimit me ujë dhe kanalizimi në Dragash,	X	X	X	X
		3. Përmirësimi i shërbimeve të "Ekoregjionit" të menaxhimit të mbeturinave si dhe përfshirja e fshatrave të mbetur në sistemin e grumbullimit dhe largimit të mbeturinave, si dhe aktivitete të tjera që janë parashikuar në planin lokal të menaxhimit të mbeturinave. Në kuadër të mbështetjes, të koordinohen dhe të zgjidhen bashkërisht problemet me të cilat ballafaqohet "Ekoregjioni", e gjitha kjo me synim përmirësimin e kushteve të përgjithshme për jetë në komunën tonë.	X	X	X	X
		4. Informimi dhe biseda me qytetarët dhe nxënësit për nevojën e mbrojtjes së mjedisit si dhe nevojën për të njohur rrezikun e zjarrit dhe rreziqeve të tjera.		X	X	
7.	Zbatimi i planit komunal për menaxhimin e mbeturinave	1. Rritja graduale e mbulimit të shërbimeve për të gjitha amvisëritë, institucionet dhe bizneset në komunën e Dragashit.	X	X	X	X
		2. Ndarja e mbeturinave në burim në shkolla dhe institucione në nivel vendor.	X	X	X	X
		3. Ndarja e mbeturinave në burim në disa vendbanime të komunës.	X	X	X	X

		4. Ndarja e mbeturinave në sheshet publike dhe hapësirat publike	X	X	X	X
		5. Themelimi i sistemit lokal për kompostim .	X	X	X	X
		6. Përcaktimi i vendndodhjeve dhe krijimi i të ashtuquajturve ishuj të gjelbër, duke u kujdesur që të mos rrezikohet shëndeti publik dhe të mos shqetësohet mjedisi.	X	X	X	X
		7. Vendosja e shportave për mbeturina rrugore nga LMT, deri në QKMF, deri në Stacionin Policorë dhe në qendrën e vjetër sociale.	X	X	X	X
8	Bashkëpunim me organizatën japoneze JICA	1. Bashkëpunim i vazhdueshëm me ekspertë nga JICA me qëllim përmirësimin e menaxhimit të mbeturinave. Zbatimi i projektit për përmirësimin e kapaciteteve të menaxhimit të mbeturinave drejt një shoqërie të shëndetshme - faza e dytë.	X	X	X	X
9.	Planet për përmirësimin e kushteve për parandalimin e zjarreve dhe mirëmbajtjen sezonale të rrugëve lokale. Përgatitja për klorimin e të gjitha sistemeve të ujësjellëseve rurale.	1. Gjatë vitit 2023, të ndërmerren të gjitha kërkimet dhe të bëjnë vlerësimin e fizibilitetit për ndërtimin, gjegjësisht instalimin e hidrantëve të zjarrit, dhe kjo e gjitha për të siguruar dhe ngritur kushtet për emergjencat në nivelin më të mirë të mundshëm, d.m.th. për të ndërhyrë. në rast zjarri, shpejtësia do të rritej në maksimum. Kjo duhet të bëhet nga një ekip i përbërë nga një anëtar nga departamenti i zjarrfikësve, një anëtar nga Hidroregjioni dhe një anëtar nga drejtoria.	X	X	X	X

		<p>2. Të sigurohet një makine që do të kontrollohej nga drejtoria për mbrojtje, shpëtim dhe shërbime publike, e cila do të ishte në dispozicion në çdo kohë në mënyrë që ekipet të mund të dalin në terren në çdo kohë dhe të hetojnë çdo lloj nevoje për përmirësimin e kushteve të punës dhe për ndërhyrje.</p>	X	X	X	X
		<p>3. Marrja në punë e disa punëtorëve sezonalë, për të mirëmbajtur rregullisht rrugët rurale dhe për të zgjatur jetëgjatësinë e tyre, (shumë rrugë rurale janë përgjysmuar nga gërryerja e tokës anës rrugës, dhe pothuajse në të gjitha fshatrat, kanalet janë të mbushur për shkak të mungesës së mirëmbajtjes, si dhe kositjes së barit të tejmbushur në anët e rrugës, të gjitha këto për të pasur dukshmëri më të mirë të rrugës).</p>	X	X	X	X

Janar 2023

Drejtör: Nuhija Tairovci



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVO-
REPUBLIC OF KOSOVO

KUVENDI KOMUNAL DRAGASH – SKUPŠTINA OPŠTINE DRAGAŠ-
MUNICIPALITY OF DRAGASH

**DREJTORIA E SHËNDETËSIS DHE MIRËQENIES
SOCIALE**

RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2022

DHE

PLANI I PUNËS PËR VITIN 2023



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
Komuna Dragash – Opština Dragaš – Municipality of Dragash
Drejtora ti për shëndetësi dhe mirëqenies sociale
Direktorijati za zdravstvo i socijalno staranje



Raporti i punës i Drejtoratit të Shëndetësis dhe Mirëqenies Sociale për periudhën
Janar – Dhjetor 2022

Drejtor
Behar Brenoli

Dragash: Janar 2023

Në bazë të Statutit të Komunës së Dragashit, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale është përgjegjëse për:

- Sigurimin e kujdesit shëndetësor primar në komunën e Dragashit, në pajtim me rregullat ligjore.
- Inspektimi i qendrave private për kujdesin shëndetësor primar.
- Vlerësimi i nevojave për mbrojtje primare.
- Ngritja e objekteve lokale për kujdesin shëndetësor primar.
- Zhvillimi i buxhetit në bazë të nevojave lokale, duke ndjekur udhëzimet e Ministrisë së Shëndetësisë
- Koordinon dhe mbikëqyr punën e QKMF, QMF dhe AMF-së.
- Funksionimi i Qendrës për Punë Sociale dhe Mirëqenie Sociale.
- Zhvillimi i një plani akomodimi për territorin e komunës.
